

TË DREJTAT DHE LIRITË THEMELORE CIVILE DHE POLITIKE

**Analizë e procedurave gjyqësorë të mbikqyrura
nga 01.09.2013 deri më 30.06.2014**



Shkup, korrik 2014

“Kjo analizë është mundësuar me përkrahjen e popullit amerikan nëpërmjet Agjencionit për zhvillim ndërkombëtar të SHBA (USAID) në kuadër të Proektit për shoqëri civile të USAID. Përmbajtja e analizës është në përgjegjësi të Komitetit të Helsinkit për të drejtat e njeriut në Republikën e Maqedonisë dhe nuk i paraqet qëndrimet e USAID ose të Qeverisë së Shteteve të Bshkuara të Amerikës”.



USAID
FROM THE AMERICAN PEOPLE



Ekipi mbikqyrës:

Dr. Voislav Stojanovski
(udhëheqës dhe autorë)

Neda Çallovska
(autorë)

Mr. Artan Murati
Mr. Katerina Ballakova
Sofija Vellkovska
Sanja Barllakovska
Hristina Shulevska



rr. Naum Naumovski Borçenr. 83
1000, Shkup, R.Maqedonisë
Tel: +389 (0)2 3119 073
Faks: +389 (0)2 3290 469

Web: www.mhc.org.mk
e-mail: helkom@mhc.org.mk

CIP – Katalogizimi i publikimit
Biblioteka kombëtare dhe universitare “Shën. Kliment Ohridski”, Shkup
342.72/.73:347.91(497.7)

STOJANOVSKI, Voislav
Të Drejtat dhe Liritë Themelore Civile dhe Politike/ [autorë Voislav Stojanovski, Neda Çallovska]. – Shkup : Komiteti i Helsinkit për të drejtat e njeriut të RM, 2014. – fq.183 : tabela, ilustr. grafik : 23 cm

Fusnota në tekst

ISBN 978-608-65216-5-3
1. Çallovska, Neda [autorë]
a) Të drejtat dhe liritë civile – Procedura gjyqësore – Maqedoni
COBISS.MK-ID 96672522

PËRMBAJTJA

HYRJE	68
PËR PROJEKTIN	72
METODOLOGJIA	76
Hulumtimi juridik.....	77
Ekipi mbikqyrës	78
Përzgjedhja e lëndëve dhe komunikimi me palët.....	78
Pyetsorë për mbikqyrje të procedurës gjyqësore	79
Analiza dhe raportet.....	79
Shkëmbimi i argumenteve dhe ndarrja e përfundimeve me palët e interesuara	80
GJETJET E EKIPIT MBIKQYRËS	82
1. E drejta për siguri dhe liri	83
2. Prezumimi i pafajsisë.....	87
3. Publiku në procedurat gjyqësore.....	90
4. E drejta e përfaqësimit nga ana e përfaqësuesit ligjorë/avokatit.....	96
5. E drejta për një gjyq të pavarur, të paanshme dhe kompetente	99
6. Barazia e armëve dhe barra e dëshmisë.....	103
7. Gjykim në afat të arsyeshëm.....	105
8. Gjetjet tjera.....	110
PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME	112
E drejta për siguri dhe liri	113
Prezumimi i pafajsisë	115
Publiciteti në procedurat gjyqësore	115
E drejta e përfaqësimit nga ana e përfaqësuesit ligjor/avokatit.....	116
E drejta për një gjykatë të pavarur, të paanshme dhe kompetente	116
Barazia e armëve dhe barra e dëshmisë.....	117
Gjykim në afat të arsyeshëm.....	118
SHTOJCA I PËRMBLEDHJE E PROCEDURAVE GJYQËSORE TË MBIKËQYRURA	120
SHTOJCA II TË DHËNA STATISTIKORE	122



I.

HYRJE

Edhe pas më shumë se 20 viteve pavarësi të Republikës së Maqedonisë, funksionimi i sistemit gjyqësor përballet me një numër të madh problemesh dhe mangesishë. Raportet për situatën e të drejtave të njeriut, si të vendit po ashtu edhe ato ndërkombëtare, pa përjashtim, e locojnë gjyqësorin si pengesë kryesore për realizimin e plotë të parimit të sundimit të së drejtës. Situata e tillë sjell pasoja negative si për qytetarët e interesuar, ashtu edhe për demokrazizimin dhe euro-integrimin e vendit. Edhe pse krahasuar me dekadën e fundit numri i rasteve gjyqësore dukshëm është ulur (fakt i cili është rezultat i transferimit të lendëve në kompetencë të noterëve dhe përmbaruesve), ende ekzistojnë problemet sistemore të cilat gjyqësori nuk arrinë t'i tejkalojë, ose i tejkalon shumë ngadalë, ose edhe i thellon. Problemi bazë konsiston në mungesën e pavarësisë së gjyqësorit nga ndikimi i pushtetit ekzekutiv, kompetencën dhe trajnime pamjaftueshëm të gjyqtarëve, jotransparenca e punës së gjykatave, jokonzistencë e praktikës gjyqësore, trajtimin jo të barabartë të qytetarëve kundrejt organeve shtetërore kur këto të fundit paraqiten si palë në procedura si dhe mungesa e mbrojtjes juridike efikase, veçanërisht në qasjen deri te e drejta, shkelja e të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm dhe prezumimit të pafajsisë.

Katër vitet e fundit janë sjellë ligje të reja ose thelbësisht janë ndryshuar ligjet ekzistuese sistemore me të cilat në mënyrë krejtësisht të re rregullohet ud-

hëheqja e procedurave gjyqësore. Ligji (i ri) për procedurën penale, ndryshimet thelbësore në procedurën kontestimore, ligjet për mbrojtje dhe pengim të diskriminimit, shqetësim në vendin e punës dhe për përgjegjësi qytetare për shpifje dhe fyerje paraqesin reformë të rëndësishme të sistemit gjyqësor. Edhe pse një pjesë e tyre përmbajnë zgjidhje të cilat janë të favorshme për qytetarët, procesi jotransparent dhe afati i shkurtër në të cilin ata u sollën e përforcoi nevojën për mbikqyrjen e zbatimit të tyre. Për atë shkak mbikqyrja e proceseve gjyqësore u realizua në bazë të temave dhe ju përkiste katër sferave: 1) mbrojtja nga tortura dhe ndëshkimet tjera mizore, qasja çnjerëzore ose degraduese 2) mbrojtja dhe pengimi i diskriminimit (përfshi edhe mobingun); 3) e drejta e fjalës dhe shprehjes; dhe 4) procedurat penale në të cilat është shkelur parimi i prezumimit të pafajsisë ose ekzistojnë dyshime për presione të ndryshme ose politike mbi pushtetin gjyqësor.

Komiteti i Helsinkit është një nga organizatat e vetme në Republikën e Maqedonisë që është me përvojë shumëvjeçare dhe në vazhdimësi bën mbikqyrjen e procedurave gjyqësore. Përveç kësaj, nëpërmjet programit për ndihmë juridike falas, Komiteti ka mundësi që të shqyrtojë të dhënat që janë pjesë përbërëse të lëndëve gjyqësore. Në këtë mënyrë, mbikqyrësit e Komitetit të Helsinkit kanë mundësi që procedurat ti ndjekin si në aspekt juridiko-shkencor po ashtu edhe në aspekt praktik. Kjo analizë është rezultat i mbikqyrjes së 35 procedurave gjyqësore në periudhën nga 1 shtatori 2013 deri më 30 qershor 2014, me fokus të veçantë në mënyrën e zbatimit të ligjeve të sipërpërmendura. Po ashtu, procedurat janë mbikqyrë edhe nga prizmi i Konventës Evropiane për Mbrojtje të të Drejtave të Njeriut, si dhe është shfrytëzuar edhe praktika gjyqësore relevante nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut të cilat i referohen parimit të gjyqimit fer dhe të drejtë.





II.

PËR PROJEKTIN

Kjo analizë është rezultat nga projekti “Mbikqyrja e procedurave gjyqësore në fushën e të drejtave dhe lirive themelore civile e politike” i përkrahur nga Projekti për Shoqëri Civile të USAID dhe implementuar nga Fondacioni Shoqëria e Hapur – Maqedoni që u realizua në periudhën nga 1 shtator 2013 deri më 30 qershor 2014.

Qëllimi kryesor i projektit ishte përforsimi i efikasitetit, pavarësisë, paanshmërisë dhe legjitimitetit të pushtetit gjyqësor në Republikën e Maqedonisë nëpërmjet:

1. Rritjes së numrit të procedurave të cilat mbikqyren nga ana e publikut;
2. Sigurimit të transparencës, dukshmërisë dhe përgjegjshmërisë për punën e gjykatave duke mbikqyrur dhe publikuar gjetjet nga ndjekja e procedurave gjyqësore si dhe duke dhënë rekomandime për tejkalimin e lëshimeve ;
3. Ndikimit në pushtetin gjyqësorë në ngritjen e respektimit të parimit të prezumimit të pafajsisë ; dhe
4. Informimit të qytetarëve për mundësinë për mbrojtjen e të drejtë për gjykim fer dhe në afat të arsyeshëm nëpërmjet parashtresave dhe kërkesave deri tek kryetarët e gjykatave, Këshillit gjyqësor të R. Maqedonisë dhe Gjykatës Supreme.

Aktivitetet kryesore të projektit përfshinë:

1. Ndjekje dhe vlerësim të procedurave gjyqësore
 - analizë dhe vërtetim të lëshimeve nëpërmjet ndjekjes së rrjedhës së procedurave
2. Konsultimeve, këshillimeve dhe orientimit të palëve
 - takime me palët dhe ndërmarje të veprimeve në bazë të kërkesave të tyre për mbikqyrje të procedurave
3. Shpërndarja e gjetjeve me publikën dhe palët e interesuara
 - njoftimi nëpërmjet raporteve të rregullta mujore
4. Reagime dhe alarmimi për rastet e shkeljeve më të rënda të parimit për gjykim fer nëpërmjet:
 - Shkresave zyrtare deri te kryetarët e gjykatave
 - parashtrësive deri te Këshilli Gjyqësor i R.Maqedonisë

Në fokus të mbikqyrjes ishin:

1. E drejta për siguri dhe liri
2. Prezumimi i pafajsisë
3. Publiciteti në procedurat gjyqësore
4. E drejta për përfaqësim nga ana e mbrojtjes ligjorë/avokatit
5. E drejta për gjyq të pavarur dhe paanshëm
6. Barazia e armëve dhe barra e dëshmisë
7. E drejta e gjykimit në afat të arsyeshëm

Ekipi mbikqyrës përbëhej nga mbikqyrës të përhershëm dhe të përkohshëm:

Dr. Voislav Stojanovski, udhëheqës projekti, Neda Çallovska, jurist i diplomuar me provim të jurisprudencës, Mr. Artan Murati, Mr. Katerina Ballakova, Sofija Vellkovska, Sanja Barllakovska i Hristina Shulevska – juristë të diplomuar.



The background of the page is a repeating pattern of stylized scales of justice. Each scale is composed of a horizontal beam with a circular weight hanging from it, and a vertical support. The scales are rendered in shades of blue and grey, and are arranged in a grid-like pattern across the entire page.

III.

METODOLOGJIA

Sipas Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) “programet për mbikqyrje të procedurave gjyqësore mund të konsiderohen si mjete për diagnostifikim, për mbledhje të informatave objektive për zbatimin e drejtësisë në rastet individuale nëpërmjet të cilave mund të përpilohen dhe shpërndahen konkluzione të cilat ju referohen më gjërësisht funksionimit të sistemit të jurisprudencës.”¹ Duke u mbështetur në këtë qëndrim dhe në përvojën shumëvjeçare në mbikqyrjen e procedurave gjyqësore, Komiteti i Helsinkit për nevojat e kësaj analizë e përpiloi analizën e mëposhtme e cila ka të bëjë me mbikqyrjen e procedurave gjyqësore në bazë të temave.

Hulumtimi juridik

Para fillimit të projektit i cili ka të bëjë me mbikqyrjen e procedurave gjyqësore në lëmin e të drejtave dhe lirive themelore qytetare e politike, ekipi mbikqyrës iu qas hulumtimit juridik të dispozitave relevante të së drejtës së vendit dhe asaj ndërkombëtare të cilat kishin të bënin me parimin e gjykimit të drejtë. Modelet të cilat u shfrytëzuan për të formuar metodologjinë juridike-shkencore për vlerësimin e procedurave gjyqësore u nxorrën nga Kushtetuta e

1 OSCE/ODIHR, *Trial Monitoring: A Reference Manual for Practitioners* (revised edition), fq. 16, Warsaw, 2012

RM-së, Ligji për procedurë penale, Ligji për procedure kontestimore, Ligji për pengim dhe mbrojtje nga diskriminimi, Ligji për përgjegjësi qytetare për fyerje dhe shpifje, Ligjit për mbrojtje të shqetësimit në vendin e punës, Konvetën Evropiane për Mbrojtje të të Drejtave të Njeriut si dhe praktika gjyqësore në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Ekipi mbikqyrës

Ekipi mbikqyrës përbëhej nga tetë mbikqyrës (të përhershëm dhe të përkohshëm) juristë dhe i ishte i ndarë në dy grupe, nga të cilët grupi i parë në përgjithësi ndjekte vetëm procedurat nga lëmi i të drejtës civile, ndërsa grupi i dytë procedurat nga lëmi i të drejtës penale. Ekipi mbikqyrës udhëhiqej nga parimet e profesionizmit, objektivitetit dhe paanshmërisë. Komiteti i Helsinkit, nëpërmjet shkresës që dërgonte nëpërmjet faksit deri te kryetari i gjykatës, gjithmonë njoftonte për qëllimin e mbikqyrësve të marrin pjesë në një gjykim të caktuar. Para se të merrnin pjesë në gjykatore, mbikqyrësit legjitimoheshin para policisë së gjykatës. Pjesëmarrja e mbikqyrësve në të shumtën e rasteve shënohej në procesverbalin për diskutimin gjyqësor, ndërsa në një numër të madh të procedurave të mbikqyrura njoftimi për pjesëmarrjen ishte pjesë përbërëse në të dhënat e gjykatës për lëndën. Në këtë mënyrë gjykatat më të larta kishin mundësi të shofin interesin e Komitetit të Helsinkit që të merr pjesë në një gjykim konkret.

Përzgjedhja e lëndëve dhe komunikimi me palët

Lëndët e ardhëshme u përzgjedhën në bazë të temës edhe atë në dy mënyra 1) në bazë të kërkesës për ndihme juridike falas dhe mbikqyrje të procedurës gjyqësore nga ana e palëve të cilat janë drejtuar deri te Komiteti i Helsinkit dhe 2) me vetëiniciativë të ekipit mbikqyrës për rastet kur nëpërmjet medias apo burimeve tjera është njoftuar për gjykime të cilat janë në kuadër të projektit. Pas kërkesës për mbikqyrje nga ana e palëve u vendimet pozitive u merrnin vetëm në rastet kur ekipi mbikqyrës vlerësonte se ekzistojnë indikacione, gjegjësisht dyshime për ekzistimin e shkelje të të drejtave qytetare dhe politike

të qytetareve. Para se të fillojë mbikqyrja nga ekipi i mbikqyrjes, palës e cila ka parashtruar kërkesë i është sygjeruar të dorëzojë dokumentet relevante të cilat kanë të bëjnë me lëndën e tyre konkrete. Pas sigurimit të dokumenteve ekipi emëronte mbikqyrës(a) të ngarkuarë për mbikqyrjen e procedurës. Në një pjesë të procedurave të cilat u ndoqën me vetë iniciativë mbikqyrësit kishin kontakt të drejtëpërdrejtë me palët, familjet e tyre, ose përfaqësuesit juridik. Në këtë mënyre mbikqyrësit kishin mundësi të përfitojnë informata plotësuese dhe të sigurojnë dokumente të rëndësishme për procedurën.

Pyetsorë për mbikqyrje të procedurës gjyqësore


Për nevojat e mbikqyrjes së procedurave gjyqësore u përgaditën disa pyetsorë të cilat përbajnë pyetjet të përgjithshme dhe pyetje specifike të cilat kanë të bëjnë me rrjedhën e procedurës dhe menyrën e udhëheqjes së saj nga ana e gjyqtarëve. Pyetjet e përgjithshme ju referohen dispozitave të përgjithshme të ligjeve procedurale (për procedurën penale dhe civile), ndërsa pyetjet specifike kanë të bëjnë me dispozitat e ligjeve konkrete (për mbrojtje nga diskriminimi dhe shqetësimi në vendin e punës dhe përgjegjësisë qytetare për fyerje dhe shpifje) të cilat paraqesin lex specialis dhe në masë të madhe parashohin afate më të ndryshme, rrjedhë të procedurës, masa kohore, barrë të dëshmisë etj.

Analiza dhe raportet

Çdo pyetsorë i plotësuar është analizuar ndaras dhe në korelacion me pyetsorët tjerë të cilët ndërlidheshin me lëminë penale apo civile. Pas analizës së pyetsorëve, është përgaditur një raport i shkurtër mbi mosrespektimin dhe lëshimet e bëra nga ana e gjykatave në lidhje dispozitat ligjore. Ekipi mbikqyrës, gjatë kohës së takimeve të rregullta, në mënyrë të detajuar diskutonte për veprimet e caktuara të gjykatave të cilat mund të vlerësohen si shkelje të procedurës. Pjesë nga raportet u publikuan në kuadër të raporteve të rregullta mujore/dymujore të Komitetit të Helsinkit për të drejtat e njeriut në Republikën e Maqedonisë. Në këtë mënyrë publiku dhe gjykatat janë alarmuar për shkeljet më të rënda të procedurës gjyqësore.

Shkëmbimi i argumenteve dhe ndarrja e përfundimeve me palët e interesuara

Gjatë hulumtimit një pjesë e përfundimeve është ndarë me kryetarin e Gjykatës Themelore Shkup 1 (në të cilën gjykatë është realizuar mbikqyrja e numrit më të madh të procedurave). Me ftesë të gjykatës, përfaqësues të Komitetit të Helsinkit kishin mundësi të realizonin një takim të përbashkët dhe të prezantojnë shkeljet e potencuara para trembëdhjetë gjyqtarëve. Nga ana e gjyqtarëve u prezantuan qëndrimet dhe pikëpamjet e tyre profesionale me çrast për një pjesë të konkluzave kishte pajtueshmëri nga të dy palët, ndërsa për pjesën tjetër ekipi kishte mundësinë të dëgjonte arsyet pse pala tjetër nuk pajtohet me përfundimet.



The background of the entire page is a repeating pattern of stylized scales of justice. Each scale is rendered in a light blue and grey color scheme, with the pans and the central beam. The scales are arranged in a grid-like fashion, slightly offset from one another to create a sense of depth and movement.

IV.

GJETJET E EKIPIT MBIKQYRËS

1. E drejta për siguri dhe liri

Neni 12 nga Kushteta e RM (i ndryshuar me amandamentin kushtetues III) përcakton se e liria e njeriut është e pacënueshme dhe ajo nuk mund ti kufizohet askujt, përveç me vendim të gjykatës dhe në procedurë të paraparë me ligj. Për ligjshmërinë e privimit nga liria, pa vonesë, vendos gjykata. Pas ngritjes së akt-akuzës, paraburgimin e përcakton ose e vazhdon gjykata kompetente, ndërsa personi i arrestuar nën kushtet e parapara me ligj mund të lëshohet dhe mbrohet në liri. Ngjashëm, neni 5 i Konventës Evropiane për Mbrojtje të të Drejtave të Njeriut parasheh që çdo njeri kako të drejtë në liri dhe siguri dhe se askush nuk mund të privohet nga liria, vetëm në bazë të ligjit.

Në pikën c) të nenit të përmendur potencohet se paraburgimi për nevojat e ndjekjes penale është i lejueshëm vetëm nëse personi është burgosur ose arrestuar për shkak të nevojës për paraqitjen para pushtetit gjyqësorë-gjykatës, kur ekziston dyshimi i arsyeshëm se ai person ka kryer veprë penale, ose kur ekzistojnë dyshime të arsyeshme që ai person të pengohet në kryerjen e ndonjë veprë penale, ose pas kryerjes së veprës penale ai person të arratiset. Çdo person i arrestuar ka të drejtë të gjykohet në një afat të arsyeshëm ose të lëshohet në liri gjatë procesit gjyqësor. Lëshimi mund të kushtëzohet me dhënien e garancionit se personi në fjalë do të paraqitet në gjykim. Sipas pikës

4 nga neni 5 i Konventës, çdo person ka të drejtë të paraqes ankesë deri te gjykata, e cila duhet të shqyrtojë ligjshmërinë e atij privimi nga liria dhe nëse ajo nuk është bërë konform ligjit, të urdhërojë lirimimin e tij. Të gjitha këto të drejta janë të garantuara dhe me detajisht të rregulluara si në ligjin e më hershëm për procedurë penale² (i cili ende zbatohet për procedurat e filluara para 1 dhjetorit 2013) po ashtu edhe në Ligjin (e ri) për procedurën penale (LPP).³

1.1 Paraburgimi si dënim

Gjatë periudhës së mbikqyrjes, në Komitetin e Helsinkit janë pranuar një numër i madh i parashtresave në lidhje me masën e paraburgimit. Në parashtresë kryesisht vërejtjet kanë të bëjnë me procedurën e përcaktimit të tij dhe vazhdimin, kohëzgjatjes, mos-shfrytëzimit të masave më të buta, mbingarkesa, kushtet e këqija për jetë dhe mbrojtje shëndetësore joadekuate. Nga procedurat penale të cilat ishin të mbikqyrura, në 10 nga 18 rastet ishte përcaktuar masa e paraburgimit kundër njëdind të akuzuarve. Duke pasur parasysh këto rrethana, Komiteti iu drejtua Drejtorisë për përmbarimin e sanksioneve dhe kërkoi të dhëna mbi kapacitetin e objekteve që shfrytëzohen për paraburgim dhe numrin e personave prezent. Sipas përgjigjes së marë, në tetor të vitit 2013 kapaciteti i njësive për paraburgim ishte 335 shtretër, ndërsa aty qëndronin 466 persona gjë që paraqet mbingarkim prej 139%. Raportuesi special për torturë nga Kombet e Bashkuara potencon se mbingarkesa në institucionet e mbyllura është e njëjtë me malltretimin si dhe me torturën.⁴ Ky qëndrim del edhe nga praktika e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut nga e cila është vërtetuar se edhe kur shteti nuk ka qëllim që të keqtrajtojë ndonjë, mbingarkimi dhe kushtet e këqija në paraburgjet është e barabartë me torturë.⁵

2 „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.15/1997; 44/2002; 74/2004; 83/2008; 67/2009dhe 51/11.

3 „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 150/2010 dhe 100/2012.

4 Kombet e Bashkuara, Asambleja e Përgjithshme, A/68/295, fq. 22, 9 gusht 2013.

5 Kallashnikov kundër Rusisë, Aplikacioni nr. 47095/99, Strasbur, 15 korrik 2002, para. 92-103.

1.2 Praktika e palejshme e përcaktimit dhe vazhdimin të paraburgimit

Nga vendimet e shqyrtuara për përcaktimin dhe vazhdimin e masës së paraburgimit, janë brengosëse arsyet e përmendura në bazë të të cilave përcaktohet paraburgimi, edhe atëherë kur për këtë masë nuk janë plotësuar parakushtet ligjore. Kjo ishte evidentet në rastin **M.Sh dhe tjerë. K.nr.23/14 në Gjykatën Themelore Shkup 1**. Gjatë arrestimit të të akuzuarve tjerë nga kjo lëndë, M.Sh ndodheshte në SHBA dhe ishte i vendosur të ballafaqohet me akuzën, në mënyrë vullnetare dhe parakohe udhëtoi për në Maqedoni, ndërsa kur u arrestua në Austri nuk e kundërshtoi kërkesën për ekstradim me çka u përjashtua mundësia për arrati. Në atë moment ai më nuk ishte person i autorizuar i sipërmarjes në të cilën kinse kishte bërë vepër penale dhe nuk ekzistonte mundësia që vepra e kryer të përsëritet, ndërsa mundësia për një ndikim eventual tek dëshmitarët ishte minimale pasi që faza e hetuesisë ishte në stadin e avansuar dhe ata ishin dëgjuar nga ana e gjyqtarit hetues. Ndikimi eventual ndaj dëshmitarëve mund të evitohet edhe nëpërmjet përcaktimit të një mase më të butë (p.sh paraburgim shtëpiak). Mirëpo, paraburgimi në kontinuitet vazhdohej, ndërsa aty M.Sh kaloi më shumë se 8 muaj. Në procedurat e mbikqyruara në të cilat si të akuzuar paraqiten më shumë persona, u konstatua se gjyqtarët edhe më tej përcaktojnë dhe vazhdojnë paraburgimin nëpërmjet vendimeve kolektive. Edhe pse vërehet një përparim gjatë përcaktimit (gjyqtarët në paragraf të veçantë ju drejtohen çdo të akuzuari individualisht), vazhdon praktika e vazhdimin kolektiv të masës për grupë të akuzuarve të cilëve ju përmenden emrat, mirëpo jo edhe arsyet pse çdo individ të akuzuar i vazhdohet masa e paraburgimit. Kjo është në kundërshtim me praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut e cila në dy aktgjykime kundër Republikës së Maqedonisë *Vasillkovski dhe tjerë. kundër Republikës së Maqedonisë* të vitit 2010 (në të cilin rast si përfaqësues juridik i ankuesit-aplikuesit ishte Komiteti i Helsinkit)⁶dhe *Milladinov dhe tjerë. kundër Republikës së Maqedonisë* të vitit 2014.⁷Në aktgjykimin e

6 Aplikacioni nr. 28169/08, Strasbur, 28 tetorë 2010.

7 Aplikacioni nr.. 46398/09, 50570/09 dhe 50576/09, Strasbur, 24 prill 2014.

parë Gjykata potencon “konfirmimi i paraburgimit për ankuesit (...) gjykatat vendore në vazhdimësi kanë përsëritur formulimin e njejtë duke përdorur fjalë identike. Duket se ata shumë pak ose aspak e kanë pasur parasysh, për rrethanat individuale të çdonjërit nga ankuesit, sepse masa e paraburgimit për ata është vazhduar me vendim kolektiv. Praktika e dhënies së vendimeve kolektive, nga ana e Gjykatës është konstatuar në kundërshtim me nenin 5 pikën 3 të Konventës, në qoftë se ajo lejon paraburgim të vazhduar për një grup njerëzish në mungesë të vlersimeve individuale të bazës për paraburgim në raport me çdo anëtar të grupit individualisht.”⁸

Në lëndën **T.K dhe tjerë. KOK.nr.51/13 në Gjykatën Themelore Shkup 1** sjellja e vendimit për vazhdimin e masës së paraburgimit kundër T.K gjykata ate veprim në procedurë e bëri kundërshtim me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut si dhe praktikës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Në fakt, u bënë shkelje thelbësore dhe procedurale në lidhje me vlerësimin dhe argumentimin mbi nevojën e vazhdimin të paraburgimit nga ana e Gjykatës Themelore Shkup 1 si dhe me mosveprimin ndaj ankesës nga ana e Gjykatës së Apelit në Shkup. Edhe në këtë rast masa për paraburgim është vazhduar në mënyrë kolektive, duke mos individualizuar arsyet për çdo të akuzuar në veçanti. Argumentet për marrjen e vendim me të cilat u vazhdua masa e paraburgimit të tetë të akuzuarve përfshihen vetëm në një faqe.

1.3 Mbikqyrja ndërkombëtare e njësive të paraburgimit

Në lëndën **A.D. dhe tjerë. KOK.nr.80/12 të Gjykatës Themelore Shkup1** nga ana e Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq (KNKQ) deri te gjykata u dërgua një kërkesë për vizitë të personave në paraburgim. Gjatë kohës së njërës nga seancat e kësaj lënde, kryetari i trupit gjykues njoftoi se kërkesa është refuzuar për shkak se KNKQ nuk është pajtuar me kushtet e vendosura nga ana e gjykatës, të cilat kishin të bënin me menyrën se si vizita duhet realizuar. Publiku prezent në seancë nuk ishte i njoftuar për detajet e kushteve të vendosura. Dëshirojmë të potencojmë se rendësinë që ka KNKQ për të drejtat e njeriut edhe ate në aspekt të mbikqyrjes së pushteteve gjatë zbatimit

⁸ Aplikacioni nr. 28169/08, Strasbur, 28 tetor 2010, para. 63.

të masës për paraburgim është e vërtetuar edhe në ligjin e vjetër edhe në Ligjin (e ri) për procedurë penale në të cilin potencohet se “përfaqësuesit e Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq kanë të drejtë pas miratimit nga ana e gjykatësit hetues të vizitojnë dhe pa mbikqyrje të bisedojnë me personat në paraburgim.” Po ashtu, mandatin ndërkombëtar i KKNKQ rrjedh nga konventat e Gjenevës nga viti 1949 në të cilat Republika e Maqedonisë është edhe nënshkruese.

Përveç refuzimit të përmendur për mbikqyrje ndërkombëtare të njësive për paraburgim, në rastin **T.K dhe tjerë. KOK.nr.51/13 në Gjykatën Themelore Shkup 1**, është refuzuar edhe kërkesa e Raportuesit special të Kombeve të Bashkuara për promovim dhe mbrojtje të të drejtës për liri të mendimit dhe shprehjes Frank La Ru i cili kërkoi të vizitojë gazetarin T.K.Kjo qasje e Gjykatës Themelore Shkup 1 i përforcoi dyshimet se njesitë e paraburgimeve në Maqedonij janë vende në të cilat nuk respektohen standardet ndërkombëtare dhe të vendit për trajtim të të arrestuarve. Nga ana tjetër, është për tu përsëritur dhënia e lejeve nga ana e disa gjykatave të vendit që përfaqësuesit e Komitetit të Helsinkit të vizitojnë disa persona të arrestuar gjatë viteve 2013 dhe 2014. Edhe pse këto leje ishin të vlefshme vetëm për biseda në hapsirën për pritje dhe nën mbikqyrje të policisë së burgut, kjo paraqet përparim kur kemi parasysh faktin që para do kohësh kërkesat tona refuzoheshin pa arsyetim ligjor.

2. Prezumimi i pafajsisë

Neni 13 i Kushtetutës së RM parasheh që personi i akuzuar për vepër penale do të konsiderohet i pafajshëm derisa fajësia e tij nuk vërtetohet me vendim të plotfuqishëm gjyqësor. Në nenin 6, pika 2 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut parashihet që çdokush i cili është i akuzuar për vepër penale trajtohet si i pafajshëm derisa fajësia e tij nuk dëshmohet në rrugë ligjore. Sipas Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dyshimi për ate nëse dikush është fajtor duhet të i shkojë në favor të akuzuarit.⁹Nëpërmjet praktikës gjyqësore,

⁹ Barbera, Meseg dhe Jabardo kundër Spanjës, Aplikacioni nr. 10590/83, Strasbur, 6 dhjetorë 1988, para. 77.

Gjykata Evropiane potencon se personat zyrtarë duhet të përmbahen nga paragjykimi i fajit të të akuzuarve. Sipas Gjykatës, neni 6, pika 2 do të shkelet në rastet kur gjyqtarë e prokurë,¹⁰ ministra dhe zyrtarë policorë,¹¹ dhe funksionarë të lartë, do të deklarojnë se personi, të cilit procesi gjyqsorë nuk i ka mbarruar, është fajtorë.¹² Kjo praktikë gjyqësore është përfshirë edhe në Ligjin (e ri) për procedurë penale. Në nenin 2, pika 2 nga ligji është paraparë që organet shtetërore, mjetet e informimit publik si dhe personat tjerë obligohet të përmbahen konform parimit të prezumimit të pafajsisë, ndërsa me deklaratet e tyre publike mbi procedurat të cilat janë në rrjedhë nuk guxojnë të shkelin të drejtat e të akuzuarit dhe të dëmtuarit, si dhe pavarsinë dhe paanshmërinë e gjykatës. Kjo mbrotje është e patjetërsueshme për të mbrojtur ligjshmërinë e procedurës dhe çlirimin nga presionet e ndryshme ndaj gjyqtarëve dhe gjyqtarëve porotë gjatë marrjes së vendimeve për lëndët. Përveç ndalesës për prejudikim të fajit nga ana e personave të përmendur, sipas Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut edhe “kampanja virtuale mediale (...) mund të ndikojë në mendimin publik i cili mund të ndikojë tek gjyqtarët porot të vendosin për fajin e të akuzuarve”.¹³

2.1 Shkelja e parimit nga ana e pushtetit dhe mediave

Gjatë disa viteve të kaluara përfaqësuesit e Ministrisë për Punë të Brendshme (MPB) ju jepnin emra disa nga arrestimeve policore. Quajtja e aksioneve policiore për shembull “Monstra” apo “Përçarës”, paraqesin shkelje të llojit të vetë të prezumimit të pafajsisë. Për rastin e mbikqyrur **A.D dhe tjerë. KOK. nr.80/12 të Gjykatës Themelore Shkup 1**, në ditën e arrestimit të të dyshuarve ministri për punë të brendshme do të deklarojë “MPB i zbuloi kryerësit e vrasjes makabre në liqenin e Smilkovës (...) ndjekës të islamit radikal...”. Në momentin që MPB do të emërojë ndonjë aksion, ai emërtimi shfrytëzohet edhe nga ana e medimeve, mirëpo po ashtu shfrytëzohet edhe në njoftimet zyrtare

10 Daktrash kundër Lituanië, Aplikacioni nr. 42095/98, Strasbur, 10 tetorë 2000, para. 42.

11 Alene De Ribemund kundër Francës, Aplikacioni nr. 15175/89, Strasbur, 10 shkurt 1995, para. 41.

12 Butkevičius kundër Lituanië, Aplikacioni nr. 48297/99, 26 mars 2002, para. 53.

13 Kraksi kundër Italisë, Aplikacioni nr.34896/97, 5 dhjetorë 2002, para. 98

të gjykatës. Kështu për shembull, në kumtesën e saj të 14 prillit 2014 Gjykata Themelore Shkup 1 thekson “në lidhje me lëndën KOK nr.80/12 i njohur si “Monstra” Gjykata themeore Shkup 1 – Shkup informon se rasti ende është në rrjedhë, mirëpo gjendet në fazën përfundimtare...”.¹⁴Në njoftimet nga gatise gjithë mediumet aspak nuk u morr në konsideratë parimi i prezumimit të pafajsisë dhe për lëndët në rrjedhë shfrytëzohen tituj ose citate në të cilat të dyshuarit paraqiten si fajtorë.

Para fillimit të gjykimit të lëndës **D.S. K.nr.1505/14 në Gjykatën Themelore Shkupi 1**, MPB publikoi njoftimi me anë të së cilit publiku u njoftua për arrestimin e personit D.S. Edhe pse MPB nuk e publikoi emrin e të arrestuarit, prezumimi i pafajsisë u shkell nga potencimi i profesionit dhe kualifikimeve të tij, emri i institucionit shëndetësor, vendi i punës momental dhe i mëparshmi duke saktësuar klinikat konkrete në Shkup.Me detajet e shpërndara, në mënyrë shumë të thjeshtë mund të arrihej tek emri dhe mbiemri i plotë i të arrestuarit. Gjatë takimit në mes përfaqësuesve të Komitetit të Helsinkit dhe trembëdhjetë gjyqtarëve në Gjykatën Themelore Shkupi 1 u ngrit edhe kjo çështje dhe nga gjyqtarë u kërkuar që ata të angazhohen në mënyrë aktive që të angazhohen në mbrojtjen e parimit të presumimit të pafajsisë sepse edhe pse shkellja e këtij parimit nuk parasheh ndonjë sanksion konkret me asnjë ligj, kjo shkelje është e papranueshme sipas Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut e cila ka supermacion mbi ligjet e vendit. Po ashtu u potencua se edhe titujt nuk duhet të ndikojnë në punën e gjyqtarëve të cilët në mënyrë profesionale e kryejnë detyrën e tyre, kjo po ashtu ka ndikim edhe në gjyqtarët porotë të cilët paraqesin shumicë në këshillat gjyqësor. Sipas qëndrimit të gjyqtarëve, shkelja e parimit të presumimit të pafajsisë me emërimet e aksioneve policore dhe njoftimet nga ana e mediave nuk është aktivitet i tyre dhe rrjedhimisht nuk mund të konsiderohet si shkelje nga ana e tyre.

2.2 Shkelja e parimit nga ana e gjykatave

Në një pjesë nga procedurat gjyqësore të mbikqyrura në të cilat kundër të akuzuarve ishte përcaktuar masa e paraburgimit, gjatë shqyrtimit të vendimeve

¹⁴ Shif: <http://www.osskopje1.mk/Novosti.aspx?novost=256> (qasja e fundit 3 korrik 2014).

për përcaktim dhe vazhdim të kësaj mase, vërejtëm se në formulimin e tekstit për arsyet se pse jepet masat e paraburgimit edhe gjyqtarët e kanë shkelë parimin e prezumimit të pafajsisë. Në fakt, në një numër të vendimeve për paraburgim të cilat ngjajnë shumë mes veti thuhet që masa e paraburgimit përcaktohet për shkak të “shkallës së përgjegjësisë penale” dhe “mënyrës së kryerjes dhe motivit për kryerje të veprave”. Dëshirojmë të potencojmë se shkalla apo niveli i përgjegjësisë penale dhe mënyra dhe motivet e kryerjes së veprave mund të vërtetohet vetëm atëherë kur përfundon shqyrtimi kryesorë dhe gjatë kohës së shqiptimit të dënimit, dhe jo gjatë kohës së hetimit apo gjatë rrjedhës së procesit gjyqësor. Në lëndën **T.K dhe tjerë. KOK.nr.51/13 në Gjykatën Themelore Shkup 1**, një nga gjyqtarët e trupit gjykues ndaj një dëshmitari u drejtuar me fjalën “gënjen!”. Kjo mënyrë e udhëheqjes së procedurës me siguri nuk ëshët në pajtueshmëri me rolin që gjyqtari e ka në procesin gjyqësorë dhe mund të interpretohet si bindje e hershme mbi ekzistimin e ndonjë fakti, para mbarimit të procedurës.

3. Publiku në procedurat gjyqësore

Neni 102 i Kushtetës së Maqedonisë parasheh që shqyrtimet para gjykatave dhe shqiptimi i aktgjykimeve janë të hapura, ndërsa publiku mund të përjashtohet vetëm në rastet e parapara me ligj. E drejta në gjykim publik garantohet edhe me nenin 6, pika 1 të Konventës Evropiane për Mbrojtje të të Drejtave të Njeriut, si dhe me nenin 5 të Ligjit për procedurë penale. Nga ana e gjykatës, publiku mund të përjashtohet edhe zyrtarisht ose me propozim të palëve ose i dëmtuari të përjashtojë publikun nga një pjesë e shqyrtimit kryesorë ose nga i tërë shqyrtimi kryesorë, nëse ajo është e nevojshme për të rruajtur shtetin, sekretet të rëndësishme ushtarake, zyrtare apo afariste, rendin publik, mbrojtjen jetës private të të akuzuarit, dëshmitarit apo të dëmtuarit, mbrojtja e sigurisë së dëshmitarit apo viktimës dhe/ose mbrojtjes së interesave të të miturit (neni 354 nga Ligji për procedure penale). Në procedurat gjyqësore për mbrojtje të të drejtave dhe detyrimeve themelore të njeriut dhe qytetarit, kontestet juridiko-civile, ku gjykata shqyrton dhe vendos sipas dispozitave të Ligjit për procedure kontestimore, shqyrtimi është publik.

Qytetarët e Republikës së Maqedonisë shumë rrallë vendosin të ndjekin ndonjë procedurë gjyqësore. Arsyet për këtë situatë janë nga më të ndryshmet dhe kanë të bëjnë me mungesën e kushteva hapsirore të gjykatave, mospasja e qasjes në gjykata, mos-informimi, mos-interesimi etj. Megjithatë, sikurse asnjëherë më parë, vitet e fundit është vërejtur një rritje e interesit për të ndjekur procedurat gjyqësore nga ana e mediave të cilët rregullisht informojnë për dhjetra procedura gjyqësore në çdokohë. Përveç mediave, në rolin e publikës në gjykatore paraqetet edhe një numër shumë i vogël i organizatave qytetare, ndërsa një numër ende më i vogël i tyre kryejnë mbikqyrje sistematike të procedurave gjyqësore. Po ashtu, një numër i caktuar i procedurave gjyqësore ndjeken edhe nga Misioni i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) në Shkup, ndonjëherë në gjykimet janë prezentë edhe përfaqësues të disa ambasadave të shteteve të huaja në Republikën e Maqedonisë. Pjesëmarrja e Misionit të OSBE në Shkup, e cila në të njejtën kohë paraqet misionin më të gjatë të organizatës që nga ekzistenca e saj, si dhe të përfaqësuesve të ambasadave në gjykimet në të cilat si palë nuk paraqiten shtetas të vetë, tregon për nivelin e ulet të shtetit të së drejtës dhe besimit të ulët që kanë ndaj sistemit të jurisprudencës në vend.

Ende ekziston praktika që disa procedura gjyqësore të udhëhiqen në zyrat e gjyqtarëve. Në ato kushte, praktikisht është e pamundur që publiku të merr pjesë në ato gjykime. Kushtet hapsinore në numrin më të madh të gjykatoreve nuk mundësojnë pjesëmarrjen e më shumë se 10 personave, ndërsa ndonjëherë ka më shumë palë dhe pjesëmarrës të drejtëpërdrejt në procedurën gjyqësore, sesa vende të lira në gjykatore. Edhe pse ekzistojnë këto kufizime hapësinore, numrimë i madh i gjyqtarëve lejojnë prezencën e publikut, mirëpo pjesëmarrësit e kanë patjetër të qëndrojnë në këmbë. Mbikqyrësit kanë vërejtur se disa herë policia e gjykatës nuk lejon hyrjen anëtarëve më të afërt familjar të palëve edhe pse në gjykatoret ka pasur vende të lira për tu ulur. Megjithatë, pas reagimit të mbrojtësit ligjorë prezenca e këtyre personave është mundësuar. Prezenca e një grupi më të vogël të qytetarëve në gjykatore në të shumtën e rasteve kontribuon në paraqitjen e turmës dhe një atmosferë ngulfatëse. Shpesh

temperatura në disa gjykatore ndikohet nga kushtet atmosferike, veçanërisht është gjendje e pakëndshme gjatë kohërave të nxehta dhe kohërave të ftohta të dimrit. Në kësi kushte është joreale të pritet që publiku do të ishte e interesuar të ndjek procedurat gjyqësore.

Për të përshëndetur ëshë shfrytëzimi i uebfaqeve të gjykatave për të publikuar agjendën e gjykimeve të caktuara. Përveç kësaj, në numrin më të madh të gjykatave përdoren televizorë LCD në të cilat mund të shihet orari i gjykimeve, si dhe numri i gjykatoreve në të cilat mbahet gjykimi. Megjithatë, do ishte e preferueshme që në gjykata të ekzistojnë edhe broshura me të cilat, ndër të tjerat, qytetarët do të informoheshin për të drejtën e tyre në çdokohë të mund të hyjnë në ndërtesën e gjykatës nëse kanë interes të ndjekin ndonjë gjykim apo gjykime.

3.1 Shkelja e parimit të publicitetit

Përveç një problemi në Gjykatën Themelore Kumanovë, ekipi mbikqyrës nuk kishte vështirësi në qasjen në gjykatoret në të cilat realizuam mbikqyrjen e proceseve gjyqësore. Në lëndën **A.G dhe tjerë. K.nr.906/13 në Gjykatën Themelore Kumanovë**, në gjykatore përveç palëve dhe përfaqësuesit të ekipit mbikqyrës prezent ishte edhe një gazetare. Kryetari i trupit gjykues, i cili nuk kishte veshur veshje gjyqtari (togë) të cilën është i obliguar ta vesh në pajtueshmëri me nenin 57 të Ligjit për gjykata,¹⁵ e pyeti gazetaren nëse për prezencën e saj ka marr leje nga Gjykata Supreme e RM. Edhe pse gazetarja me të drejtë u mundua të i sqarojë se sipas Ligjit për procedurë penale leja është e nevojshme vetëm për inçizimi audio dhe video ose për fotografim, kryetari i trupi gjykues në konsultim dhe me miratim të përfaqësuesit të prokurorisë publike e udhëzoi gazetaren të drejtohet te kryetari i gjykatës dhe të pyet nëse ka të drejtë të qëndrojë në gjykatore.

Gjatë një shqyrtimi tjetër gjyqësor për lëndën e njejtë, në momentin kur mbikqyrësi arriti afër ndërtesës së Gjykatës Themelore Kumanove, nga ana e policisë së gjykatës iu kërkua leje për pjesëmarrje në gjyq me çrast ai e

15 „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 58/06, 35/08 dhe 150/2010.

tregoi identifikimi zyrtar dhe i informoi përfaqësuesit e policisë së gjykatës se kryetari i gjykatës dhe kryetari i trupit gjykues janë të informuar për pjesëmarrjen e tij, dhe se duhet të ndjek shqyrtimin për lëndën që veç kishte marr pjesë dy herë me, se gjykimi është publik dhe se nuk ka nevojë për leje të posaçme për pjesëmarrje dhe se ndalesa për hyrje në ndërtesën e gjykatës do të ishte jokushtetuse dhe jashtëligjore. Ky argumentin nuk u pranua nga ana e policisë së gjykatës e cila mbikqyrësit nuk i lejoi të hyr në ndërtesën e gjykatës. Pas kësaj ngjarjeje Komiteti i Helsinkit menjëherë dërgoi parashtrësë deri te kryetari i gjykatës. Kryetari i gjykatës duke u thirrur në një Rregullore të vjetër të gjykatës e cila ka përfunduar të vlejë dhe në dispozitat të cilat kanë të bëjnë me sigurimin e ndërtesave, pronës, njerëzve dhe mbjates së rendit dhe dicitlinës në ndërtesën gjykatës konstatoi se policia e gjykatës me të drejtë ka kërkuar leje ose ftesë. Për këtë shkelje flagrante të parimit të publicitetit Komiteti i Helsinkit dërgoi parashtrësë deri te Këshilli Gjyqësor i RM, mirëpo deri në mbylljen e kësaj analize, edhe pse u tejkalua afati ligjorë prej dymuajsh për përgjigje, nuk është dërguar vendimi i Këshillit.

3.2 Transparenca e gjyqtarëve dhe inçizimi/fotografimi i procedurave

Edhe ligji i vjetër (neni 314) edhe Ligji (i ri) për procedurë penale (neni 363) parashih që para fillimit të diskutimit kryesorë gjegjësisht shqyrtimit kryesorë, kryetari i trupit gjykues, përveç obligimeve tjera, detyrimisht duhet të paraqes përbërjen e trupit (gjyqësorë). Nga të gjitha lëndët e ndjekura në lëmin e materies penale, vetëm para fillimit të lëndës **M.E. KOK.nr.107/13 të Gjykatës Themelore Shkup 1** kryetari e paraqiti trupin gjykues. Edhe pse nuk paraqet ndonjë shkelje thelbësore të ligjit, vlerësojmë se kjo dispozitë është e rëndësishme si në aspekt të transparencës së procedurës, ashtu edhe për përgjegjshmërinë e anëtarëve të trupave gjykes.

Në pajtueshmëri edhe me (nenin 310) ligjin e vjetër edhe me Ligjin (e ri) për procedurë penale (neni 360), në gjykatore nuk mund të bëhen inçizimi filmike dhe televizive. Me përjashtim, kur ekziston leje nga kryetari i Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë, gazetarët mund të inçizojnë një pjesërisht

shqyrtimin kryesorë. Gjatë ndjekjes së procedurave gjyqësore, mbikqyrësit e Komitetit të Helsinkit në disa nga rastet kur bëhej shqyrtimi kryesorë në Gjykatën Themelore Shkupi 1, vërejtën se këshilli i përjashtonte gazetarët pas inçizimit të disa inserteve të shkurta edhe ate para se të fillojë shqyrtimi kryesorë. Për shkak kësaj praktike të gjykatës, publiku nuk mund të fitojë një pasqyre të plotë mbi kushtet në kuadër të së cilave udhëhiqet një lëndë penale, dhe lejohet hapsirë për lëshime gjatë informimit medial.

Nuk është kontestuese se gjyqtari udhëheqës gjegjësisht trupi gjykues mund të vendos që pjesë nga shqyrtimi kryesorë mos të inçizohet, nga procedurat e mbikqyrura gjermëtani u konstatu se personat që inçizojnë largohen nga gjykatoret duke mos u marr asnjë vendim i cili në formë të shkruar do të evidentohet në proces-verbal. Me këtë qasje nuk respektohet në tërësi leja e kryetarit të Gjykatës Supreme. Për këtë lëshim u diskutua edhe gjatë takimit të përfaqësuesve të Komitetit të Helsinkit me trembëdhjetë gjyqtarët në Gjykatën Themelore Shkup. Sipas gjyqtarëve, kushtet hapsirore nuk lejojnë inçizimin e gjithë shqyrtimit gjyqësorë, ndërsa dhënia e lejeve të gjithë mediumeve që kërkojnë nga Gjykata Supreme kontribuon në trajtimin e barabartë të tyre. Megjithatë, pas takimit, në lëndën **A.D dhe tjerë. KOK. nr.80/12** kameramanëve dhe fotoreporterëve ju mundësua të inçizojnë në tërësi shpalljen e aktgjykimit që paraqet një hap në drejtim të duhur dhe meriton të vlerësohet.

Në aspekt të inçizimit/fotografimit të procedurave civile, Ligji për procedurë kontestimore nuk përmban dispozita të veçanta me të cilat do të lejohet apo ndalohet inçizimi gjegjësisht fotografimi i procedurës gjyqësore. Megjithatë, Rregulloja e gjykatës¹⁶ e rregullon këtë çështje në nenin 103, pika 3 në të cilën potencohet se inçizimi vizuel (video) dhe inçizimi me zë (audio), njoftimi dhe fotografimi në procedurën kontestimore dhe në procedurën e kontestit administrativ mund të kryet pas miratimit të kryetarit të gjykatës, pasi është siguruar mendimi nga gjyqtari që merret me lëndën dhe me pëlqim në formë

¹⁶ „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë “ nr. 66/2013.

të shkruar nga ana e palëve. Vlerësojmë se koncipimi i tillë i nenit ka të bëjë me esencën e kontesteve, të cilat janë juridiko-civile.

Sipas dispozitave të Ligjit për procedurë kontestimore udhëhiqen edhe kontestet gjyqësore për shpifje, fyerje dhe diskriminin. Për shkak të natyrës, këto konteste mund të jenë të rëndësishë së veçantë për publikun, për këtë shkak është i nevojshëm edhe inçizimi vizuel (video) dhe me zë (audio) i diskutimeve që ndodhin në gjykatat civile për këto lëndë. Mirëpo, sipas përmbajtjes së nenit 104 të Rregullores së gjykatës, pëlqim duhet të japin edhe palët e lëndës, gjë që shumë rëndë mund të arrihet.

Në lëndën **A.A dhe tjerë. PO 121/13 në Gjykatën Themelore Gostivar** në të cilën kërkohej vërtetimi i diskriminimit në bazë të përkatësisë politike, u dërgua kërkesa për inçizim vizuel (video) dhe me zë (audio) për shqyrtimin kryesorë, për të cilin rasti mendim pozitiv dhanë edhe kryetari i trupit gjykues edhe paditësit. Mirëpo, për shkak të refuzimit të të paditurve, kërkesa u refuzua.

3.3 Dëshmitari i mbrojtur si arsye për përjashtim të publikut

Duke ndjekur procedurat gjyqësore në të cilat si dëshmitarë paraqiten persona me identitet të fshehur, ekipi mbikqyrës vërtetoi se publiku sipas rregullit përjashtohet nga gjykatoret. Në këtë kontekst, në mënyrë të veçantë duam të potencojmë rastin **L.B dhe tjerë. KO.nr.2917/12 në Gjykatën Themelore Shkup 1**. Për këtë rast gjyqësorë nga ana e prof.Dr. Gordan Kalajxhiev, u dërgua njoftimi se i njejtë në kapacitetin e njohësit si shkencëtar, si profesor i procedurës penale në fakultetin Juridik “Justinijani I” dhe kryetar i Komitetit të Helsinkit, do të mbikqyr procedurën gjyqësore. Mendim pozitiv që publiku profesional/shkencorë mos të jetë i përjashtuar nga pyetjet e dëshmitarit të mbrojtur dhe e prokurori publik, si propozues i dëshmitarit, me çrast ishte rasti i parë kur u tregua një vullnet i mirë nga ana e prokurorisë publike për transparencë më të madhe në procedurën e dëgjimit të dëshmitarit të mbrojtur. Megjithatë, trupi gjykues vendosi të përjashtojë publikën në tërësi, duke përfshirë edhe publikun profesional. Gjykojmë se vendimet e njëpasnjëshme të trupit gjykues për të përjashtuar publikun për lëndët ku paraqiten dëshmitarë të mbrojtur

nuk lejon hapsirë për të vërtetuar nëse realizohet parimi i gjykimit fer dhe të drejtë.

Në veçanti nuk e konsiderojmë të arsyeshëm përjashtimin e publikut profesional, i cili do të ndjekë vetëm mënyrën e dëgjimit të dëshmitarit të mbrojtur, me qëllim të vërtetohet zbatimi i dispozitave ligjore me të cilat rregullohet mënyra e mbrojtjes së dëshmitarëve në Republikën e Maqedonisë dhe ndikimit të tyre në parimin e gjykimit fer dhe të drejtë. Dëshirojmë të potencojmë se në të ardhmen trupat gjykues duhet të shfrytëzojnë mundësinë e paraparë në nenin 355 pika 2 nga Ligji (i ri) për procedure penale (dispozitë e cila ishte prezente edhe në ligjin e mëparshëm), në shqyrtimin kryesorë në të cilin është përjashtuar publiku të marrin pjesë persona zyrtarë, punëtorë publik dhe shkencëtarë. Për këtë mundësi është diskutuar gjatë takimit të përfaqësuesve të Komitetit të Helsinkit me trembëdhjetë gjyqtarët e Gjykatës Themelore Shkup. Përfaqësuesit e Komitetit të Helsinkit potencuan se do të vazhdojnë të dërgojnë kërkesa në cilësinë e njohësve shkencorë dhe punëtorëve publik, ndërsa gjyqtarët u pajtuan që çdo kërkesë të trajtohet enkas për çdo lëndë.

4. E drejta e përfaqësimit nga ana e përfaqësuesit ligjorë/avokatit

Neni 12 i Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë parasheh që çdo person ka të drejtë në përfaqësues ligjorë/avokat në procedurë gjyqësore. Në nenin 6, pika c, të Konventës Evropiane për Mbrojtje të të Drejtave të Njeriut parashihet që çdokush ka të drejtë të mbrohet vetëm ose me ndihmën e mbrojtësit sipas zgjidhjes së tij, ndërsa nëse nuk posedon mjete për të paguar mbrojtës, të fitojë avokat zyrtarë pa pagesë kur këte e kërkojnë interesat e drejtësisë. Në nenin 70 të Ligjit (të ri) për procedurë penale, në tërësi është marrë kjo dispozitë e konventës. Sipas praktikës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, kur vendoset nëse interesat e drejtësisë kërkojnë mbrojtje falas sipas detyrës zyrtare, të rëndësishëm janë tri faktorë: serioziteti i veprës penale dhe pesha

e dënimit të mundshëm; ndërlikueshmëria e lëndës; dhe aspektet sociale dhe personale të të akuzuarit.¹⁷

Para se të vendoset nëse një personi i do i caktohet një mbrojtës falas dhe sipas detyrës zyrtare, nga personi nuk guxon të kërkohet të dëshmojë “përtej çdo dyshimi” se nuk mund të lejojë tëa paguaj për përfaqësimin e tij ligjor.¹⁸ Më tutje, neni 8 i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut (e drejta e privatësisë) garanton privilegjin e besueshmërisë në mes të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij. Sipas praktikës se Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, komunikimi në mes të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij ka karakter privat dhe raport të besueshëm.¹⁹

4.1 Roli i përfaqësueve/mbrojtësve në procedurat gjyqësore

Pas mbarimit të fakultetit juridik, personi i cili ka për qëllim të punojë si avokat e ka të patjetërsueshme të bëjë praktikë në punë juridike më së paku dy vjet dhe të jep provimin e jurisprudencës. Shkollimi juridik karakterizohet si mësim shumë teorik dhe gatise nuk përfshinë praktikë në gjykatore. Puna praktike në të shumtën e rasteve realizohet vetëm formalisht, ndërsa kandidatët shumë rrallë përfitojnë aftësitë e nevojshme për përfaqësim të klientëve. Me marrjen e lincencës për avokat, të njejtët njohuritë dhe aftësitë e tyre i avansojnë vetëm me iniciativë personale, gjegjësisht nuk ekziston një sistem i mësimi të vazhdueshëm. Në të shumtën e rasteve të mbikqyrura gjyqësore palët në procedurë kanë pasur mbrojtës të cilët i kanë zgjedhur vetë. Mbikqyrësit nuk kanë hasur në asnjë refuzim të emërimit të mbrojtësit pa pagesë sipas detyrës nga ana e gjykatave. Përkundrazi, në lëndën **J.B dhe tjerë. KOK nr.59/12 në Gjykatën Themelore Shkup 1** avokat pa pagesë iu caktua një personi të punësuar kundër të cilit në fund të procedurës iu shqiptuar dënimi me kusht. Sipas kësaj, mund të përfundojmë se praktika gjyqësore e cila ka të bëjë me caktimin e mbrojtësit sipas detyrës zyrtare është në pajtueshmëri me Kushtetutën, Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe ligjet.

17 Kuaranta kundër Zvicrës, Aplikacioni nr. 12744/87, 24 maj 1991, para. 33-35.

18 Pakeli kundër Gjermanisë, Aplikacioni nr. 8398/78, 25 prill 1983, para. 34.

19 Kembel kundër Mbretërisë së Bashkuar, Aplikacioni nr. 13590/88, 25 mars 1992, para. 48

4.2 Avokat zyrtar pa pagesë

Mbikqyrësit vërejtën se mbrojtësit e caktuar sipas detyrës zyrtare nuk janë gjithmonë aktiv në lëndët në të cilat përfaqësojnë palë të cilët nuk posedojnë mjete për të angazhuar mbrojtës sipas zgjidhjes së tyre. Kjo ishte evidente në lëndën **V.L dhe tjerë. KOK.nr.8/08 në Gjykatën Themelore Shkup 1** ku dukej qarte se me aktiv ishin avokatet e palëve që përfaqësonin me pagesë sesa ata që ishin caktuar sipas detyrës zyrtare. Kjo gjendje e sjell në pikëpyetje efektivitetin e mbrojtjes së atyre qytetarëve të cilët nuk janë në gjendje të angazhojnë mbrojtës sipas zgjidhjes së tyre. Edhe përkundër joaktivitetit të disa nga mbrojtësit zyrtarë, ekipi mbikqyrës nuk vërejti ndonjë rast në të cilin gjykatësi reagoi për mbrojtje joadekuate. Dëshirojmë të theksojmë se sipas praktikës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut gjykatat e kanë patjetër të reagojnë kur të vërejnë një mbrojtje joadekuate nga ana e mbrojtësve zyrtarë ose për një mbrojtje të tillë të kuptojnë në formë tjetër.²⁰

Lëshimet më të mëdha në sistemin e sigurimit të mbrojtësve sipas detyrës zyrtare janë mosekzistenca e rregullave të qarta gjatë përcaktimit, si dhe mosveprimi i atyre mbrojtësve pas mbarimit të procedurës në shkallë të parë. Mbrojtës sipas detyrës zyrtare cakton gjykata nga lista e vetë interne të avokatëve të interesuar. Avokatët në ato lista janë zakonisht të rinjë dhe angazhimin e tyre si mbrojtës sipas detyrës zyrtare e shfrytëzojnë për të fituar përvojë. Nuk ekziston ndonjë sistem për përzgjedhje të rastësishme të mbrojtësit nga ana e regjistrimit zyrtarë. Kjo situatë kontribuon në krijimin e një lirie të madhe të gjykatave gjatë vendosjes se cili mbrojtës të caktohet. Kompenzimin që e marrin avokatët zyrtarë është dyfish më i vogël sesa ai i përcaktuari me tarifën e avokatëve.

Ekipi mbikqyrës nga ana e avokatëve zyrtarë u informua se gjykatat kompenzimin e paguajnë me vonesa të mëdha, shumë shpesh ndodhë që pagesat të bëhen pas përfundimit të plotë të procesit gjyqësorë. Kjo në mënyrë plotësuese e sjell në pikëpyetje efektivitetin e mbrojtjes. Mbrojtësit zyrtarë marrin kompenzim vetëm për përfaqësimin e tyre në shkallën e parë.

²⁰ Çekala kundër Portugalisë, Aplikacioni nr. 38830/97, 10 tetor 2002, para. 60.

Për shkak të kësaj situate ata nuk dërgojnë ankesa për aktgjykimet e shkallës së parë. Mos-shfrytëzimi i mjeteve juridike mund të ketë pasoja negative për palet, veçanërisht për ata që ndodhen në paraburgim apo burg, nuk e njohin gjuhën maqedonase, ose janë analfabetë.

5. E drejta për një gjyq të pavarur, të paanshëm dhe kompetent

Neni 12 i Kushtetutës së RM (i ndryshuar me amandamentin kushtetues XXV) përcakton që pushtetin gjyqësor e ushtrojnë gjykatat. Gjykatat janë autonome dhe të pavarura. Gjykatat gjykojnë në bazë të Kushtetutës dhe ligjeve si dhe marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara në pajtueshmëri me Kushtetutën. Llojet, kompetenca, themelimi, abrogimi, organizimi dhe përbërja e gjykatave, si dhe procedura pranë tyre, rregullohen me ligj. Në nenin 6, pika 1 nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut parashihet, në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose të çdo akuze penale kundër tij, çdo person ka të drejtë për një proces të drejtë dhe publik, brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj. Sipas praktikës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në qoftë se gjykatësi vendimin e tij e ka të bazuar para se ti shqyrtojë provat të cilat do mbështeste rezonimin e tij, ajo do të vlerësohet si e pa bazë dhe e palejueshme sipas nenit 6, pika 1 të Konventës.²¹

E rëndësisë së veçantë për pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqtarëve është ekzistimi i një sistemi për përzgjedhjen e rastësishme të lëndëve të cilat ata do ti procedojnë. Gjykatat në Republikën e Maqedonisë shfrytëzojnë një sistem të unifikuar informativ për administrim të lëndëve gjyqësore (AKMIS) nëpërmjet të cilit, mes tjerash, në mënyre automatik bëhet shpërndarja e lëndëve për gjyqtarë dhe ndjeket lëvizja e lëndëve. Po ashtu është i rëndësishëm edhe përzgjedhja e gjyqtarëve e cila në Republikën e Maqedonisë, në pajtim me nenin 38, pika 1 nga Ligji për gjykata²² të cilët nuk kanë kufizim të mandatit.

21 Fej kundër Austrisë, Aplikacioni nr. (14396/88, 24 shkurt 1993, para. 34.

22 „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.58/06, 35/08, dhe 150/10.

Krahasuar me bartësit e funksioneve publike, pagat e gjyqtarëve në Republikën e Maqedonisë janë relativisht të larta që duhet të ndikojnë në pavarsinë dhe paanshmërinë e tyre.

Që një gjykatë të vlerësohet si e paanshme, është e patjetërsueshme që në të të punojnë gjyqtarë të cilët i përfaqësojnë të gjithë përfaqësuesit e komuniteteve në vend. Në Raportin e Avokatit të Popullit mbi ndjekjen dhe zbatimin e parimit të përfaqësimit të drejtë për vitin 2012 potencohet “duke analizuar përmbledhjen e të dhënave të tubuara nga 27 gjykata themelore në teritorin e Republikës së Maqedonisë për vitin 2012 mund të konstatohet kjo situatë e përfaqësimit të komuniteteve: Maqedonas – 83,8%, Shqiptarë – 10,5%, Turq – 1,6%, Romë – 0,9%, Serb – 1,0%, Vllehë – 1,3%, Boshnjakë – 0,5% dhe të tjerë 0,4%. Në gjykatat themelore ekziston një përparim i ulët i planit në zbatimin e parimit të përfaqësimit të drejtë në krahasim me vitet e kaluara, më çrast potencojmë tempon e ngadalësuar të punësimit të personave të cilat nuk i përkasin komunitetit shumicë, veçanërisht në përfaqësimin në pozitat udhëheqëse.”²³Situata është e ngjashme edhe në katër Gjykatat e Apelit. Sipas të dhënave, përveç Vllehëve, asnjë nga komunitetet pakicë nuk është e përfaqësuar drejtë në gjykatat e vendit.

Pavarsia dhe paanshmëria e gjyqtarëve shihet edhe në aspekt të qasjes së tyre ndaj pjesëmarrësve tjerë në procedurë (të akuzuar, dëmtuar, prokurorë publikë, paditës, të paditur, mbrojtës, etj). Ekipi mbikqyrës ka vërejtur se gjyqtarët në përgjithësi janë profesionistë në aspekt të raportit të tyre me pjesëmarrësit tjerë në procedurë, mirëpo ende ekziston një afërsi e caktuar në mes gjyqtarëve dhe prokurorëve publik si dhe një raport më i favorshëm nga ana e gjyqtarëve ndaj avokatëve më të vjetër dhe me më përvojë, në krahasim me raportin që kanë ndaj avokatëve me më pak përvojë.

Dyshime për anshmëri u vërejtën në lëndën **J.V. dhe tjerë. KOK nr.59/12 në Gjykatën Themelore Shkup 1**. Pikërisht, në ditën kur ishte planifikuar

²³ Avokati i Popullit, Raporti mbi ndjekjen dhe zbatimin e parimit të përfaqësimit të drejtë për vitin 2012, faqe. 28-30, Shkup, prill 2013, për më shumë: <http://ombudsman.mk/upload/documents/2013/Izvestaj%20-SPZ%20-za%202012.pdf> (qasja e fundit: 4 korrik 2014).

shpallja e aktgjykimit, trupi gjykues vendosi që lënda të kthehet në fazën e shqyrtimit kryesorë dhe në të njejtin moment, në mosdijeni të të akuzuarit dhe mbrojtësit të tyre, kumtoi se para gjyqit do të dëshmojë personi i cili kinse është dakorduar të shes pronën me J.V. Dëshmitari deklaronte se për tokën ai ka negocijuar në emrin e tij dhe në emër të fqinjëve të tij të cilët e kanë autorizuar me aurotizim në formë të shkruar. J.V. mohonte se ndonjëherë është takuar me dëshmitarin me çka mbrojtësi kërkoi që autorizimi në fjalë të prezantohet para gjyqit si provë. Në atë çast trupi gjykues e lëshoi gjykatoren dhe pas konsultimit 20 minutësh kumtoi se propozimi refuzohet, dhe se procedura gjyqësore përfundon.

Në aktgjykimin me të cilin gjithë të akuzuarit u shpallën fajtorë, dëshmia e dëshmitarit u shfrytëzua si një provat kryesore për fajin e J.V.

Në lëndët **A.D dhe tjerë. KOK.nr.80/12** dhe **T.K dhe tjerë.KOK.nr.51/13 në Gjykatën Themelore Shkup 1** u vërejtë lëshimi i gjykatores nga ana e një gjyqtari anëtar i trupit gjykues gjatë rrjedhës së procedurës. Në lëndën **A.D dhe tjerë. KOK.nr.80/12** kryetari i trupit gjykues i pyeti mbrojtësit e të akuzuarve a ka nevojë të ndërpritet procedura derisa gjyqtari, anëtar i trupit gjykues, ka shkuar të pijë ujë me çrast ata u përgjigjen negativisht dhe procedura gjyqësore vazhdoi pa prezencën e tij. Në lidhje me këte, dëshirojmë të potencojmë se në pajtueshmëri me nenin 307 nga ligji i vjetër dhe nenin 357 nga Ligji (i ri) për procedurë penale kryetari, anëtarët e trupit gjykues dhe procesverbalisti si dhe gjyqtarët dhe gjyqtarët porotë duhet pandërprerë të jenë pjesëmarrës në shqyrtimin kryesorë. Miratimi nga ana e mbrojtësve që një gjyqtarë të lëshojë seancën nuk i liron anëtarët tjerë të trupit gjykues të veprojnë në kundërshtim me ligjin.

Në aspekt të kompetencës së gjykatave, vo lëndën **V.Ç dhe tjerë. RO nr.96/2013 në Gjykatën Themelore Gostivar** e cila kishte të bënte me diskriminimin për shkak të përkatësisë partiake, është sjelle vendim gjyqësorë negativ për paditësit, me vërejtje të trupit gjykues se paditësit para se të dërgojnë padi është dashur të paraqesën parashtrësë deri tek Komisioni për mbrojtje nga diskriminimi. Me këtë rast dëshirojmë që gjyqtarëve në

Republikën e Maqedonisë të ju potencojmë se Komisioni për mbrojtje nga diskriminimi është organ i pavarur i cili sjell mendime dhe rekomandime në lidhje me parashtresat e dërguara për diskriminim eventual dhe nuk paraqet ndonje parakusht për mbrojtje gjyqësore nga diskriminimi.

Pa dallim nëse viktimat e diskriminimit janë drejtuar ose jo deri te Komisionin për mbrojtje nga diskriminimi, mund të nisnin procedurë gjyqësore për vërtetim dhe mbrojtje nga diskriminimi. Në rastet kur është iniciuar procedura gjyqësore dhe kur ekziston një mendim nga Komisionin për mbrojtje nga diskriminimi, mendimi mund të shfrytëzohet si provë në procedurën gjyqësore, e cila sërish, në asnjë mënyrë nuk e obligon gjykatën të sjell vendim të njejtë. Në nenin 26 të Ligjit për pengim dhe mbrojtje nga diskriminimi është paraparë që Komisioni vepron në bazë të parashtresave dhe nëse nuk është iniciuar procedura gjyqësore për rastin e njejtë ose nuk është vendosur me vendim meritor. Në rastet kur është filluar procedura në Komisionin për mbrojtje nga diskriminimi dhe ky komision ende nuk ka marr vendim mbi parashtresën e dërguar, viktimat eventuale e diskriminimit mund të nis procedurë gjyqësore dhe për atë të informojë Komisionin për mbrojtje nga diskriminimi, me çrast procedura në Komision do të ndërpritet.

5.2 Gjyqtarët porotë

Konkluzat e përgjithshme nga gjitha lëndët e ndjekura në aspekt të gjyqtarëve porotë është se ata nuk perceptohen si pjesë përbërëse e trupit gjykues i cili vendos për lëndën konkrete edhe pse në trupin gjykes ata janë shumicë me të drejtë vote gjatë vendim-marjes. Për këtë perceptim, me sjelljen e vetë kontribuojnë edhe gjyqtarët porotë, të cilët në një pjesë të procedurave janë të painteresuar dhe e lëshojnë gjykatoren duke mos marrë pjesë në shqyrtim apo para se të përfundojë seanca. Në lëndën A.A dhe tjerë.RO 121/13 në Gjykatën Themelore Gostivar, një nga gjyqtarët porotë e lëshoi gjykatoren gjatë kohës së shqyrtimit kryesorë në periudhën kur njëri nga të paditurit jepte deklaratë. Në këtë rast, vendimi u soll vetem gjysëm ore pasi përfundoi shqyrtimi kryesorë. Ekipi mbikqyrës, në procedurat që mbikqyrte, nuk vërejti as një pyetje të

parashtruar nga gjyqtarët porot edhe pse kjo e drejtë ju lejohet sipas Ligjit për procedurë penale.

6. Barazia e armëve dhe barra e dëshmisë

6.1 Barazia e armës

Sipas praktikës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, barazia e armëve paraqet edhe mundësi të barabartë për çdo palë në procedurë të paraqesë pikëpamjet e veta dhe të sqarojë argumentet e veta në lidhje me rastin konkret në procedurën gjyqësore me kusht që palën mos ta sjellin në një pozitë të disfavorshme vis-a-vis kundërshtarit të tij.²⁴ Në numrin më të madh të aktgjykimeve që kanë të bëjnë me gjykimin e drejtë të garantuar me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Gjykata Evropiane barazinë e armëve e vlerëson si pjesë përbërëse të vetë Konventës. Në nenin 14 të ligjit të vjetër dhe nenin 15 të Ligjit (të ri) për procedurë penale parashihet që gjykata dhe organet shtetërore janë të obliguar që me kujdes të njejtë të ekzaminojnë dhe vërtetojnë si faktet që e ngarkojnë të akuzuarin, po ashtu edhe ata fakte që i shkojnë në favor. Në aspekt të barazisë së armëve në procedurën penale dëshirojmë të përqëndrojmë debatin publik në lëndën **J.V dhe tjerë. KOKZH. nr.9/14 pranë Gjykatës së Apelit Shkup.** Nga ana e Prokurorit të lartë publik u tregua që në procedurën për lëndën konkrete prokuroria me akt-akuzën dhe me aktgjykimin dënues të shkallës së parë ka provuar se të akuzuarit e kanë kryer veprën, derisa të akuzuarit nuk kanë arritur të provojnë të kundërtën. Dëshirojmë të potencojmë lëshimi i akt-akuzës *per se* dhe aktgjykimi dënues i shkallës së parë nuk do të thotë që vepra penale që ju ngarkohet të akuzuarve është kryer nga të njejtët, derisa të sjellet vendimi i formës së prerë nga ana e gjykatës. Po ashtu, barra e provës për të provuar fajin e të akuzuarve është ekskluzivisht në anën e prokurorisë dhe është detyrim i saj që të njejtën ta dëshmojë.

²⁴ De Haes dhe Zhizel kundër Belgjikës, Aplikacioni nr. 19983/92, 24 shkurt 1997, para. 53.

6.2 Barra e dëshmisë

Me miratimin e Ligjit për pengim dhe mbrojtje nga diskriminimi, dispozitat e Ligjit për marrëdhënie pune të cilat i referohen mbrojtjes nga shqetësimi në vendin e punës, më tutje edhe Ligji për mbrojtje nga shqetësimi në vendin e punës dhe Ligji për përgjegjësi qytetare për fyerje dhe shpifje, parashohin që barra e dëshmisë bie në anën e të paditurit, nëse paditësi me gjasë ka qenë viktimë e diskriminimit, shqetësimit në vendin e punës apo edhe i fyerjes dhe shpifjes. Transferimi i barrës së dëshmisë dhe respektimi i së njëjtës paraqet rëndësi të madhe, si në aspekt të mbrojtjes së viktimave, po ashtu edhe në aspekt të ndjekjes së praktikës ndërkombëtare dhe legjislacionit të Unionit Evropian.

Nga procedurat e mbikqyrura në këto lëmi ekipi mbikqyrës konstatoi se gjyqtarët nuk posedojnë përvojë praktike, dhe as që mundohen të krijojnë një praktikë të transferimit të barrës së dëshmisë në anën e të paditurit. Si shembull do ta potencojmë procedurën **A.A dhe tjerë. RO 121/13 në Gjykatën Themelore Gostivar**, i cili kishte për bazë vërtetimin e diskriminim në bazë të përaktësisë politike. Në këtë rast edhe pse ekziston një numër i madh i provave për të dëshmuar se është kryer diskriminim nga ana e të paditurve, gjykata vendosi që mos të transferojë barrën e dëshmisë në anën e të paditurve ndërsa procedura u udhëhoq si procedurë e thjeshtë civile në të cilën paditësit duhej të dëshmonin bazën e kërkesë-padisë. Mandej, përveç avokatit-të autorizuar, të paditurit nuk ishin prezent në shqyrtimin kryesorë.

Transferimi i barrës së dëshmisë mbi të paditurin është e rëndësisë së veçantë në rastet e diskriminimit dhe shqetësimit në vendin e punës, për shkak se grumbullimi i provave nga ana e paditësit është vështirësuar sepse jo çdo herë paditësit kanë qasje në informatat me të cilat do të dëshmojnë diskriminim eventual, gjegjësisht shqetësimin. Po ashtu, ky fakt ndikon në efikasitetin e ngritjes së procedurës për vërtetimin e diskriminimit, gjegjësisht shqetësimit, me anë të së cilës mund të kërkohen masa të përkohëshme për mbrojtje nga viktimizimi.

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut në disa nga vendimet potencon se transferimi i barës së dëshmisë është e rëndësishë së jashtëzakonshme veçanërisht në procedurat në të cilat kërkohet konstatimi i diskriminimit. Një nga vendimet e rëndësishme të kësaj natyre është D.H dhe tjerë. Kundër Çekisë në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut në të cilën thuhet: “nësë ankuesi i cili potencon se ekziston diskriminimi dhe bën një supozim të themeluar se ndikimi i ndonjë mase apo praktikte është diskriminuese, barra e dëshmisë i bie shtetit, i cili e ka të patjetërsueshme të dëshmojë se trajtimi i tillë nuk është diskriminues (...). Duke pasur parasysh veçorinë e fakteve dhe natyrën e gjetjeve në këtë lloj të rasteve (...), praktikisht do të ishte shumë rëndë që ankuesit të dëshmojnë se ka ekzistuar një diskriminim indirekt, pa mos e transferruar barrën e dëshmisë”.²⁵

7. Gjykim në afat të arsyeshëm

Neni 12 i Kushtetutës së RM (i ndryshuar me amandamentin kushtetues XXV) përcakton që pushtetin gjyqësor e ushtrojnë gjykatat. Gjykatat janë autonome dhe të pavarura. Gjykatat gjykojnë në bazë të Kushtetutës dhe ligjeve si dhe marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara në pajtueshmëri me Kushtetutën. Llojet, kompetenca, themelimi, abrogimi, organizimi dhe përbërja e gjykatave, si dhe procedura pranë tyre, rregullohen me ligj. Në nenin 6 nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut parashihet që, në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose të çdo akuze penale kundër tij, çdo person ka të drejtë për një proces të drejtë dhe publik, brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e themeluar me ligj.

Në nenin 6, pika 2 e Ligjit mbi gjykatat parashihet që gjatë marrjes së vendimeve për të drejtat dhe obligimeve të qytetarëve dhe gjatë vendosjes për përgjegjësi penale, çdokush ka të drejtë në gjykim të drejtë dhe publik, në afat të arsyeshëm dhe para gjykatës së pavarur dhe paanshme të themeluar me ligj. Në nenin 10 është përcaktuar se procedura para gjykatës rregullohet me ligj dhe formohet në bazë të disa parimeve, në mes të cilëve edhe parimi i

²⁵ D.H dhe tjerë. Kundër Çekisë, Aplikacioni nr. 57325/00, 13 nëntor 2007, para. 130.

grykimit në afat të arsyeshëm. Neni 36 i Ligjit mbi grykatat parasheh mbrojtje të veçantë në rast të shkeljeve të së drejtës për grykim në afat të caktuar nga ana e Grykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë. Është e paraparë që pala që konsideron se grykata kompetente iaka shkelë të drejtën për grykim në afat të arsyeshëm të dërgojë kërkesë për mbrojtje të të drejtës për grykim në afat të arsyeshëm deri te Grykata Supreme e Republikës së Maqedonisë.

7.1 Vonesa e procedurës gryqësore

Është një perceptim i përgjithshëm se grykatat ndonjëherë nuk i respektojnë dispozitat e Ligjit për procedurë penale në aspekt të afateve për përpilimin e aktgrykimeve. Nuk respektohet afati prej 15 ditësh i llogaritur nga mbyllja e seancës kryesore, ndërsa është vërejtur rast edhe i tejkalimit të afatit deri në 60 ditë për rastet më të komplikuar. I tillë është rasti nga lënda **L.B dhe tjerë. KO.nr.2917/12 në Grykatën Themelore Shkup 1** në të cilin rast nga dita e përfundimit të procedurës së shkallës së parë deri në ditën e dërgimit të aktgrykimit kanë kaluar më shumë se 4 muaj, në fakt dyfishi i afatit të fundit të paraparë me ligj.

Po ashtu, në rastin **J.V dhe tjerë. KOK.nr.59/12 në Grykatën Themelore Shkup 1** aktgrykimi i shkallës së parë deri të J.V i cili në atë moment ishte duke vuajtuar dënimin e mëhershëm, u dërgua 106 ditë pas shpalljes së tij. Për aktgrykimi i shkallës së parë u dërgua edhe ankesë, ndërsa Grykatës së Apelit në Shkup i duheshte më shumë se shtatë muaj për të caktuar shqyrtim publik mbi rastin **J.V dhe tjerë. KOKZH.nr.9/14 në Grykatën e Apelit në Shkup** në prill të vitit 2014. Kur shqyrtimi publik duhej përfundimisht të mbahej, grykata e prolongoi për në maj për shkak se J.V nuk u sjell në grykatë nga ENP “Idrizovë”. Në maj, drejtoria e burgut, duke mos ia kumtuar arsyet grykatës, sërish nuk e solli të akuzuarin. Mos-zbatimi i vendimeve të grykatës nga ana e organeve të administratës shtetërore flet për qasjen jokorrekte të institucioneve tjera ndaj grykatës. Përveç faktit që kjo praktikë ndikon në kohëzgjatjen e procedurave gryqësore, e njejta mund të ndikojë në shkeljen e të drejtave të të akuzuarve të cilët ndodhen në paraburgim, situatë për të cilën Ligji për procedurë penale parasheh procedurë urgjente gryqësore.

Gjykatat shpesh herë e shkelin të drejtën për gjykim në afat të arsyeshëm. Përveç rasteve të përmendura, shkelje janë hasur edhe në disa lëndë tjera si në procedurën penale po ashtu edhe në procedurën civile. Në lëndën **K.K K.nr.-534/13 në Gjykatën Themelore Gostivar**, e cila ka të bëjë me veprën penale Përdhunim, është paraqitur më 09.10.2008, në momentin kur edhe pretendohet se ka ndohur rasti kritik, akt-akuza në gjykatë është sjellur më 21.06.2011, gjegjësisht pasi ka kaluar 2 vite e 10 muaj nga denoncimi. Procedura, sërish, para gjykatës zgjat 3 vite, për shkak se vendimet e gjykatës së shkallës së parë, dy herë abrogohen nga gjykata e shkallës së dytë dhe ende nuk ekziston vendim i formës së prerë për lëndën. Vlerësojmë se ky rast në të cilin nga momenti i denoncimit kanë kaluar 5 vite e 10 muaj dhe ende nuk ekziston vendim gjyqësor i formës së prerë, tregon se nuk ekziston një mbrojtje e fakte kur bëhet fjalë për dhunën seksuale ndaj femrave.

Në aspekt të dispozitave të Ligjit për procedurë penale për shpalljen e aktgjykimit shkelje u vërejt në lëndën **ZH.K K.nr.-534/13 në Gjykatën Themelore Gostivar**, në të cilin kryetari i trupit gjykues pas mbarrimit të shqyrtimit kryesorë shpalljen e aktgjykimit e caktoi për disa orë, mirëpo në afatin e caktuar nuk u paraqit për shkak të një takimi, me çrast dha arsyetim se aktgjykimin do ta shpall për disa ditë. Edhe për kundër këtij njoftimi, aktgjykimi nuk u shpall edhe pasi kaloi një javë, për shkak se gjyqtari paska shkuar në pushim. Me këto veprime, duket qartë se bëhet shkelje e nenit 370 nga Ligji për procedurë penale në të cilin parashihet se nga momenti që gjykata e kumton aktgjykimin, kryetari i trupit gjykues menjëherë do ta shpallë të njejtin. Nëse gjykata nuk ka mundësi të shpall aktgjykimin në ditën e njejtë pas mbarrimit të shqyrtimit kryesorë, do të prolongoj shpalljen e aktgjykimit më së pakupër tri ditë dhe do të caktojë kohën dhe vendin e shpalljes së aktgjykimit.

Nga procedurën civile si shembull do të potencojmë lëndën **B.J. RO – 225/11 në Gjykatën Themelore Shkup 2**. Edhe pse vendimi ishte pozitiv për paditësin dhe i vërtetuar shkelja e të drejtave në marrëdhëniet e punës, procedura zgjati 2 vite e 5 muaj, që është një kohëzgjatje ekstremisht e gjatë për kontestet në marrëdhëniet e punës. Neni 405 nga Ligji për procedurë kontestimore

parasheh që procedura për kontestet në marrëdhëniet e punës, veçanërisht gjatë përcaktimit të afateve dhe seanca dëgjimore/rochishte, gjykata çdoherë do i kushtojë rëndësi të veçantë nevojës për zgjidhje të shpejtë kontesteve në marrëdhëniet e punës. Në kontestet mbi marrëdhëniet e punës të cilat kanë të bëjnë me ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, seanca për shqyrtim kryesorë duhet patjetër të mbahet në një afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të përgjigjes ndaj padisë. Në procedurën e kontesteve mbi marrëdhëniet e punës, procedura para gjykatës së shkallës së parë patjetër duhet përfunduar në një afat prej gjashtë muajsh nga dita e ngritjes së padisë. Duke pasur parasysh strukturën e tillë të dispozitave, rezulton se gjykata ka udhëhequr procedurë e cila është 4 herë me e gjatë sesa afati i paraparë në Ligjin për procedurë konkestimore, me çka, pa asnjë dyshim rrjedh se është shkelur e drejta për gjykim në afat të arsyeshëm, e cila pa dyshim mund ndikojë në jetën private dhe familjare të paditësit, kur i njeiti ngren padinë për ndërprerje të marrëdhënieve të punës në mënyrë të jashtëligjshme.

Në lëndën **A.ZH VPP 232/12 në Gjykatën Themelore Shkup 2**, bëhet fjalë për kompensim të pronës së eksproprijuar. A.ZH pas 13 viteve procedurë gjyqësore përfundimisht ka pritur momentin që ti vërtetohet kompensimi i pronës së tij të marrur nga koha e ish Jugosllavisë. Ai në vitin 2011 nëpërmjet përbarruesit është munduar të nxjerr të hollat e kërkuara nga ana e shtetit me çrast ka pasur ankesa nga ana e Avokaturës së Shtetit me të cilën potencohen që në vitin 2010 ka kërkuar përsëritje të procedurës, ndërsa në vitin 2011 ka dorëzuar prova të reja në gjykatë. Vendimi mbi nevojën e përsëritjes së procedurës është në rrjedhë edhe për faktin që A.ZH. deri në Gjykatën Supreme ka dërguar kërkesë për gjykim në afat të arsyeshëm të cilën gjykata ia ka pranuar dhe e ka urdhëruar gjykatën e shkallës së parë që procedurën ta kryej në afat prej 3 muajsh. Edhe për faktin që lënda zgjat 16 vite dhe është skaduar afati të cilin Gjykata Supreme ia urdhëroi gjykatës së shkallës më të ulët, për të zgjidhur lëndën, gjykata e shkallës së parë ende nuk ka sjellë vendim. Ky shembull përveç faktit që tregon mosefikasitetin e shkajshëm të gjykatës, po ashtu tregon edhe mostrajtimin e njejtë dhe të drejtë që gjykata bën ndaj palëve në kontestet gjyqësore kundër shtetit.

Ndonjëherë shkaktues të gjyqimit në afat të paarsyeshëm janë edhe vetë palët në procedurë.

Kështu për shembull, në lëndën **V.L dhe tjerë. KOK.nr.8/08 në Gjykatën Themelore Shkup 1** në të cilin rast si të akuzuar paraqiten mbi 70 persona, gjykimi disa herë shtyhet për shkak se njëri ose disa nga të akuzuarit nuk ju përgjigjet ftesave të gjykatës. Në njëërën nga seancat në të cilën nuk ishte prezent një nga të akuzuarit, kryetari i trupit gjykuesju sygjeroi të pranishmëve që të informojnë ate që mungonte se në rast se sërish nuk paraqitet në seancë kundër ti do të shqiptohet masa e përkohëshme paraburgim. Edhe pse është për tu përhëndetur përkushtimi i gjyqtarit që udhëheq lëndën të bëjë ate në kuadër të afatit të arsyeshem, është e paqartë pse nuk u soll urdhëresë gjyqësor për arrest nga ana e policisë për të marr pjesë në seancën e cila tanimë zgjat 6 vite.

7.2 Shpallja dhe përpilimi i aktgjykimeve

Në aspekt të afateve për shpallje dhe përilim të aktgjykimeve gjykatat shumë shpesh nuk i respektojnë dispozitat e Ligjit për procedurë kontestimore. Aktgjykimet gatisen asnjëherë nuk shpallen menjëherë pas mbylljes së shqyrtimit kryesorë, sipas nenit 324, pika 3 nga Ligji për procedurë kontestimore, edhe pse jo çdoherë bëhet fjalë për lëndë të komplikuar. Nuk respektohet as afati për shpallje deri më tetë ditë nga mbyllja e shqyrtimit kryesorë, në rastet kur bëhet fjalë për lëndë më të ndërlikuar, sipas nenit 324, pika 4 nga Ligji për procedurë kontestimore. I ngjashëm është rasti edhe me përpilimin e aktgjykimeve në gjykata, gjegjësisht edhe në këtë aspekt vërehet mosrespektimi afateve ligjore gjatë përpilimit dhe dërgimit të aktgjykimeve, në kontekst të nenit 326, pika 1 nga Ligji për procedurë kontestimore, në të cilin thuhet se aktgjykimi i kumtuar duhet të përpilohet në formë të shkruar në afat prej 8 ditëve, ndërsa për rastet më të ndërlikuar më së voni në afat prej 15 ditëve nga dita e kumtimit. Shpallje të vendimit menjëherë pas përfundimit të shqyrtimit kryesorë kishtenë lëndën **A.A dhe tjerë RO 121/13 në Gjykatën Themelore Gostivar**, për vërtetimin e diskriminimit në bazë të përkatësisë partiake.

8. Gjetjet tjera

8.1 Qasja në gjykata

Ekipi mbikqyrës vërtetoi se qasja në gjykata përgjithësisht është në nivel të pakënaqshëm. Disa gjykata nuk kanë hyrje të veçantë për personat e arrestuarit ose të paraburgosur dhe shpesh ndodh që këta persona të hyjnë në gjykatë nëpërmjet hyrjes kryesore, gjegjësisht hyrjes së vetme në gjykata. Sjelljet e policisë në gjykatë dallojnë nga ajo e gatise mospasjes kontrollë fare gjatë hyrjes në ndërtesën e gjykatës (p.sh Gjykata Themelore Tetovë), deri në kontrole të rrepta të qytetarëve. Kontrole të rrepta bëhen në Gjykatën Themelore Shkup 1, mirëpo patjetër duhet të potencohet fakti që policia e gjykatës vepron në mënyrë profesionaëe dhe me respekt për ata që hyjnë në ndërtesën e gjykatës. Nuk ekzistojnë hapsira të veçanta për të pranuar të miturit, po ashtu nuk ekzistojnë hapsira për veshje – garderoberë, shpesh herë ndodh që pjesëmarrësit mos të jenë veshur në mënyrë të përshtatshme me temperaturat e gjykatoreve. E gjithë kjo sjell një situatë në të cilën të paditurit dhe paditësitë shpesh të takohen në korridoret e gjykatave dhe ndonjëherë shkaktohen zënka verbale dhe krijohet atmosferë e papërshtatshme. Pranë gjykatores më të madhe të gjykatës më të madhe – Shkup 1 nuk ekziston asnjë karrige ndërsa palët, dëshmitarët dhe publiku ndonjëherë detyrohen të presin me orë të tëra duke qëndruar në këmbë.

Gatise në të gjitha gjykatat në të cilat mbikqyrëm procedurat gjyqësore, banjot janë në një gjendje shumë të keqë, nuk mirëmbahen rregullisht dhe kjo nuk i ngjan rolit që ka gjyqësia në shoqëri.

8.2 Organizatat qytetare si palë të përfshira në procedurat gjyqësore

Duke shfrytëzuar të drejtën për pjesëmarrje në procedurë si palë të treta/përfshira, si organizata gjegjësisht shoqata të qytetarëve të cilët në kuadër të veprimtarisë së tyre merren me mbrojtjen e të drejtave për trajtim të barabartë për ato të drejta të cilat vendoset në procedurë (neni 39 nga Ligji për pengim dhe mbrojtje nga diskriminimi) Rrjeti për mbrojtje nga diskriminimi dorëzoi

kërkesë për përfshirje nga ana e paditësve në lëndën **A.A dhe tjerë. RO 121/13 në Gjykatën Themelore Gostivar** e cila kërkesa u pranua nga ana e gjykatës. Sipas nenit 196 të Ligjit për procedurë kontestimore pala e përfshirë është e autorizuar të shpreh propozime dhe të ndërmerr të gjitha veprimet kontestimore në afatet në gjitha veprimet që ka mund ti ndërmerr pale së cilës i është bashkangjitur. Në këtë mënyrë, organizatat e qytetarëve, të cilat në një periudhë më të gjatë veprojnë në mbrojtje nga diskriminimi mund të kenë rol aktiv në procedurat gjyqësore për vërtetim të diskriminimit, të parashtrojnë pyetje, të japin propozime, prova, të paraqesin ankesa.

E përshëndetim vendimin e tillë të gjykatës për të lejuar përfshirjen e organizatave të qytetarëve në procedurat gjyqësore, e cila, vlerësojmë se duhet të bëhet praktikë, veçanërisht kur bëhet fjalë për procedura gjyqësore në të cilat kërkohet vërtetimi dhe mbrojtja nga diskriminimi, me çrast organizatave të qytetarëve ju jepet mundësia të kenë rol aktiv në procedurat gjyqësore në dëshmimin e diskriminimit.

The background of the entire page is a repeating pattern of stylized scales of justice. Each scale is rendered in a light blue and grey color scheme, with the pans slightly tilted. The pattern is dense and covers the entire area.

V.

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

E drejta për siguri dhe liri

Në një numër të madhë të procedurave gjyqësore është shqetësuese praktika e marrjes së vendimeve në lidhje me përcaktimin dhe zgjatjen e masës së paraburgimit pa mos argumentuar se cilat janë arsyet për një vendim të tillë. Ekziston praktika e zgjatjes kolektive të paraburgimit për një grup të të pandehurve të cilëve iu përmenden emrat, por vendimet nuk përmbajnë rishikim individual të arsyeve për secilin të akuzuar sa i përket zgjatjes së masës së paraburgimit. Vendime të tilla merren në kundërshtim me të drejtën vendore dhe ndërkombëtare si dhe praktikës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Paraburgimi zgjatë shumë kohë, madje edhe pas përfundimit të hetimeve dhe marrjes në pyetje të të akuzuarit. Është shqetësues fakti që nuk po përdoren masa më të buta siç është garancioni. Njësitë e paraburgimit nëpër burgje janë të mbingarkuara në atë masë sa që vetë qëndrimi në to për shkak të kushteve të këqija për jetë dhe mbrojtjes shëndetësore jo të përshtatshme mund të konsiderohet si torturë.

REKOMANDIME:

1. Masa e paraburgimit të përdoret si një përjashtim e jo si rregull, kohëzgjatja të reduktohet në kohën më të shkurtër të nevojshme dhe në rradhë të parë të shqyrtohet mundësia e shfrytëzimit të masave parandaluese të buta.

2. Gjatë përcaktimit dhe në veçanti gjatë zgjatjes së masës së paraburgimit gjyqtarët të marrin parasysh praktikën e jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, në mënyrë të detajuar të shpjegojnë dhe t'i shqyrtojnë arsyet në bazë të të cilave kanë vendosur për një masë të tillë, të ndalojnë praktikën e anulimit të vendimeve identike me formulime stereotipe dhe të zhvillojnë një qasje individuale kundrejt çdo të akuzuari duke e braktisur praktikën e sjelljes së vendimeve kolektive për paraburgim.
3. Gjatë vizitave të rregullta javore në njësitë e paraburgimit gjyqtarët përgjegjës për mbikëqyrjen e kushteve në të cilat jetojnë të paraburgosurit t'i kushtojë vëmendje të veçantë kategorive të qytetarëve në nevojë dhe atyre të cilët kanë nevojë për shërbime shëndetësore. Gjatë identifikimit të shkeljeve të të drejtave, gjyqtarët që kryejnë mbikëqyrjen t'i informojnë gjyqtarët që kanë qenë në procedurën e mëparshme për gjendjen e personave të paraburgosur dhe nevojën që disa të burgosur të dërgohen në spital jashtë paraburgimit.

Prezumimi i pafajësisë

Ekziston praktika nëpërmjet së cilës shkilet prezumimi i pafajësisë nga personat zyrtarë, funksionarët dhe mediumet. Gjykatat nuk reagojnë ndaj shkeljeve të tilla, dhe në disa raste vet shkelin prezumimin e pafajësisë, sidomos nëpërmjet vendimeve me të cilat e përcaktojnë ose e vazhdojnë masën e paraburgimit.

4. Gjyqtarët të reagojnë kur oficeri i policisë, zyrtarët publik dhe mediat e shkelin prezumimin e pafajësisë të personave për të cilët në procedurë e sipër është hetimi apo procesi gjyqësorë.
5. Të ndalohet praktika e përcaktimit të vendimeve për paraburgim në të cilat janë të përfshira formulime që mund të përdoren vetëm në dhënien e dënimit, dhe jo gjatë kohës së hetimeve apo procesit gjyqësorë.

Publiciteti në procedurat gjyqësore

Qytetarët në Republikën e Maqedonisë kanë shumë pak interes për të marrë pjesë në procedurat gjyqësore në rolin e publikut. Opinioni aspak nuk është i informuar për mënyrën sipas të cilës mund ta ushtroj të drejtën e vet për të marrë pjesë në gjykatore gjatë procedurave gjyqësore. Ekziston praktika që disa procedura gjyqësore të zhvillohen në kushte të papërshtatshme në zyrat e gjyqtarëve. Shpesh kameramanëve dhe ekipeve të gazetarëve u lejohet të regjistrojnë / kapin inserte të audiencës në sallën e gjyqit para seancës kryesore, por jo edhe në vet seancën dëgjimore. Opinioni publik sipas rregullës dhe pa arsytim përjashtohet. Është për tu përshëndetur shfrytëzimi i monitoreve për paraqitjen e seancave gjyqësore të planifikuara në gjyq dhe përditësimi i rregullt i seancave gjyqësore në faqen e internetit të gjykatave.

REKOMANDIME:

6. Të futet sistemi “i pari që vjen, i pari shërbehet” në të gjitha gjykatore në të cilat ka kushte hapësinore për pranimin e publikut, ndërsa policia gjyqësore, sa herë që ka kushte, qytetarëve t’ua mundësoj hyrjen e shpejtë dhe të lehtë në gjykatore.
7. Anëtarëve të kameramanëve dhe ekipeve të gazetarëve të cilëve kryetari i Gjykatës Supreme të RM-së ka dhënë leje për regjistrim apo fotografim gjatë procedurës t’u lejohet të regjistrojnë të gjithë procedurën gjyqësore ose pjesë të saj, por më pastaj pjesmarrësve në procedurë t’u tregohet e drejta për privatësi dhe moszbulim të të dhënave personale.
8. Gjatë procedurave gjyqësore në të cilën merr pjesë dëshmitar i mbrojtur t’i lejohet publikut, dhe sidomos bashkëpunëtorve profesional të marrin pjesë në sallën e gjyqit sepse nuk ekziston nevoja që dëshmitari i mbrojtur edhe njëher të mbrohet. Në rastin e përjashtimit të publikut të sillet vendim në të cilin do të shpjegohen arsyet për përjashtimin e publikut.

E drejta e përfaqësimit nga ana e përfaqësuesit ligjor/avokatit

Është për t'u përshëndetuar praktika e emërimit të avokatit mbrojtës falas, që më pastaj nga personi që pohon se nuk ka mjete për të angazhuar avokat në mënyrë zyrtare t'i kërkohet që deklaratën e tillë ta vërtetoj. Nuk ka sistem për përzgjedhje të rastësishtme të avokatit sipas detyrës zyrtare që çon në liri të tepruar të gjyqit gjatë vendosjes se cili avokat nga lista e brendshme do të thirret. Gjyqtarët nuk i zëvendësojnë avokatët sipas detyrës zyrtare edhe kur është e qartë se ai është pasiv dhe në mënyrë jo efektive e përfaqëson klientin e tij.

REKOMANDIME:

9. Të zhvillohet një sistem për përzgjedhje të rastësishtme të avokatit sipas detyrës zyrtare dhe ai sistem të integrohet me sistemin ekzistues informatik për menaxhimin automatik me lëndët gjyqësore (ACMIS).
10. Sa heqë që gjyqtarët do të vërejnë se avokati i emëruar sipas detyrës zyrtare është pasiv, nuk përfaqëson interesat e klientit, ose në mënyrë jo efektive e drejton mbrojtjen, të emërojnë avokat tjetër sipas detyrës zyrtare.

E drejta për një gjykatë të pavarur, të paanshme dhe kompetente

Në Republikën e Maqedonisë ende nuk është siguruar përfaqësim i drejtë në mes të gjyqtarëve nga bashkësitë etnike pakicë. Disa gjyqtarë kanë qëndrim të ndryshëm ndaj pjesmarrësve të ndryshëm në procedura gjatë së cilës shihet afërsi më e madhe me prokurorët publik dhe statusit të privilegjuar ndaj avokatëve më të vjetër dhe më me përvojë. Është vërejtur praktika e lënies së sallës së gjyqit nga gjyqtarët dhe gjyqtarët porotë gjatë kohës së zhvillimit të gjyqimit dhe apo të seancës dëgjimore.

REKOMANDIME:

11. Gjykatat të miratojnë program për punësime të ardhëshme të gjyqtarëve që u takojnë bashkësive etnike pakicë në shtet.
12. Gjyqtarët të marrin qëndrim neutral dhe të balancojnë raportin ndaj të gjithë pjesmarrësve në procedurë pavarësisht profesionit dhe përvojës së tyre. Të ndërpritet praktika e lëshimit të sallës së gjyqit nga ana e gjyqtarëve dhe gjyqtarëve porotë, derisa në atë sallë zhvillohet procedura gjyqësore.

Barazia e armëve dhe barra e dëshmisë

Gjyqtarët nuk reagojnë kur përfaqësuesit e prokurorive publike presin dhe kërkojnë nga të akuzuarit vet të dëshmojnë se nuk janë fajtorë. Procedurat gjyqësore që kërkojnë përcaktimin e diskriminimit trajtohen në të njëjtën mënyrë si procedurat e tjera civile. Për shkak të ndjeshmërisë së lëndëve, si dhe për faktin që në të shumtën e rasteve të diskriminuarit nuk posedojnë informacion dhe të dhëna të cilat ekskluzivisht i ka vetëm i padituri. Dëshmi të tilla, të dhëna ose deklarata të të paditurit janë të një rëndësie të madhe për dëshmi të asaj se a ka pasur ose nuk ka pasur diskriminim në rastin konkret dhe mund të sigurohen vetëm nëqoftëse i padituri dëshmon se në rastin konkret nuk ka pasur diskriminim.

REKOMANDIME:


13. Gjyqtarët dhe prokurorët publik të respektojnë parimin ei incumbit probatio *qui dicit, non qui negat*, respektivisht barrën për dëshmin e provave ta ketë ai i cili pohon e ajo ai i cili mohon.
14. Të sigurohet teknologji audio-video me të cilën do të mund të regjistrohen të gjitha procedurat gjyqësore me çka gjykata, prokuroritë publike, paditësi dhe i padituri do të kenë një pasqyrë të vërtetë në zhvillimin e përgjithëshëm të procesit gjyqësorë.
15. Gjykatat t'i qasen zbatimit të institutit për hudhjen e barrës së dëshmimit të provave nga ana e të paditurit në procedurat gjyqësore që kërkojnë mbrojtje nga diskriminimi.

Gjykim në afat të arsyeshëm

Duke pasur parasysh kohëzgjatjen e një pjesë të lëndëve të mbikëqyrura në këtë projekt, si dhe ankesat e vazhdueshme nga ana e qytetarëve dhe vendimet që ata i marrin nga Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë dhe nga Gjykata Evropian për të Drejtat e Njeriut me të cilat u njihet shkelja e së drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm dhe përcaktimin e kompensimit, mund të kontatohet jo-efikasitet në veprimtarin e gjykatave. Veçanërisht është shqetësues fakti që akush nuk i respekton procedurat e parashikuara si urgjente, si në procedurat penale ashtu edhe në procedurat civile, të cilat ndikojnë në realizimin e të drejtave të tjera të parapara me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë dhe marrëveshjeve ndërkombëtare.

REKOMANDIME:

16. Të rritet numri i bashkëpunëtorëve profesional dhe deri në fund të respektohen dispozitat e procedurave të cilat duhet të sigurojnë efikasitet gjatë veprimtarisë së gjykatave. Veçanërisht e rëndësishme është se efikasiteti në vete përfshin edhe ekspertizën.
17. Gjyqtarët në lëndët penale më shpesh ta shfrytëzojnë mundësinë për nxjerrjen e urdhërit për arrestim të dhunshëm për pesonat të cilët dukshëm edhe pa asnjë arsye të mirëfillët nuk u përgjigjen thirrjes së gjykatave.



SHTOJCA I

PËRMBLEDHJE E PROCEDURAVE GJYQËSORE TË MBIKËQYRURA

GJA – Gjykata e Apelit, GJTH – Gjykata Themelore

Nr. ren.	LËNDA	GJYKATA KOMPETENTE	BAZA LIGJORE/VEPRA PENALE
1	L.B. KZH.nr.-2114/13	GJA Shkup	Neni.123 i KP, Vrasje
2	J.V. KOKZH.nr.9/14	GJA Shkup	Neni.279 i KP, Shmangie të tatimit
3	M. V. K-432/13	GJTH Manastirë	Neni.130 i KP, Lëndime trupore
4	S.D. K-490/12	GJTH Manastirë	Neni.237 i KP, Vjedhje
5	I.S. K.nr.161/14	GJTH Velesë	Neni.143 i KP, Torturë në shërbim
6	ZH.K K-534/13	GJTH Gostivarë	Neni.186 i KP, Përdhunim
7	A.A. dhe tjerë. PO 121/13	GJTH Gostivarë	Neni 3 dhe 6, alineja 1 Diskriminim
8	V.Ç dhe tjerë. PO nr.95/2013	GJTH Gostivarë	Neni 3 dhe 6, alineja 1 Diskriminim
9	N.V. KO.nr.71/2014	GJTH K. Pallankë	Neni 367 i KP, Dhënia e dëshmisë së rrejshme
10	T.F. K.nr.35/2009	GJTH Koçan	Neni 247 i KP, Mashtrim
11	A.G. dhe tjerë. K.nr.906/13s	GJTH Kumanovë	Neni 382 i KP, Pengim të personit zyrtar për marrjen e veprimeve zyrtare
12	R.Z. PO 118/13	GJTH Ohër	Mobing

Nr. ren.	LËNDA	GJYKATA KOMPETENTE	BAZA LIGJORE/VEPRA PENALE
13	A.D. dhe tjerë. KOK.nr.80/12	GJTH Shkup 1	Neni 123 i KP, Vrasja
14	T.K. dhe tjerë KOK.nr.51/13	GJTH Shkup 1	Neni 353 i KP, Keqpërdorim i detyrës zyrtare
15	V.L. dhe tjerë. KOK.nr.8/08	GJTH Shkup 1	Neni 279 i KP, Shmangie të tatimit
16	D.S. dhe tjerë. KOK.nr.10/14	GJTH Shkup 1	Neni 279 i KP, Shmangie të tatimit
17	M.E. dhe tjerë. KOK.nr.107/13	GJTH Shkup 1	Neni 316 i KP, Spiunim
18	M.SH. K.nr.23/14	GJTH Shkup 1	Neni 353 i KP, Keqpërdorim i detyrës zyrtare
19	G.M. dhe tjerë. K.6p.1644/13	GJTH Shkup 1	Neni 137 i KP, Shkelja e barazisë së qytetarëve
20	S.M. kundër J.K. P4-30/13a	GJTH Shkup 2	Neni 6, alineja 1 i Ligjit për përgjegjësi qytetare për shpifje dhe ofendim
21	Z.L. RO nr.179/14	GJTH Shkup 2	Mobing
22	K.K. P2 - 1270/12	GJTH Shkup 2	Neni 40 i Ligjit për familje, divorci
23	V.K. RO 215/14	GJTH Shkup 2	Mobing
24	N.G. kundër J.S. P4 742/14	GJTH Shkup 2	Neni 6, alineja 1 i Ligjit për përgjegjësi qytetare për shpifje dhe ofendim
25	ZH.T. P4-99/13 A	GJTH Shkup 2	Neni 6, alineja 1 i Ligjit për përgjegjësi qytetare për shpifje dhe ofendim
26	G. kundër Z.S. P4-90/13A	GJTH Shkup 2	Neni 6, alineja 1 i Ligjit për përgjegjësi qytetare për shpifje dhe ofendim
27	D.S. K.nr.1506/14	GJTH Shkup 2	Neni 279 i KP, Shmangie të tatimit
28	A.ZH VPP 32/12	GJTH Shkup 2	Neni 241 i LGJPJ, Kompensim për pronën e eksproprijuar
29	V.H. dhe tjerë. K.nr.366/13	OC Тетово	Neni 162 i KP, Rysfjet gjatë zgjedhjeve dhe votimit
30	A.J. K.nr.814/13	OC Тетово	Neni 133 i KP, Kërcënim me armë të rrezikshme gjatë rrahjeve dhe zënkave


GJITHËSEJ SEANCA
DËGJIMORE TË MBIKËQYRURA:

105


SHTOJCA II

TË DHËNA STATISTIKORE

Grafikoni nr.1: Lëndët gjyqësore të mbikëqyrura në bazë të lëmisë



Grafikoni nr.2: Lëndët e mbikëqyrura në bazë të gjykatave



Grafikoni nr.3: Procedurat e mbikëqyrura sipas bazës ligjore ose veprës penale

